



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.85

12 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 127
datë 11.5.2009

Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributin e burimeve për misionin e Kombeve të Bashkuara në Republikën e Afrikës Qendrore dhe në Republikën e Çadit (MINURCAT)”

3711

Ligj nr.10 128
datë 11.5.2009

Për tregtinë elektronike

3726

Ligj nr. 10 129
datë 11.5.2009

Për gjendjen civile

3734

LIGJ
Nr.10 127, datë 11.5.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.2, DATË 8.4.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR KONTRIBUTIN E BURIMEVE PËR
MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE DHE
NË REPUBLIKËN E ÇADIT (MINURCAT)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 101 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributin e burimeve për misionin e Kombeve të Bashkuara në Republikën e Afrikës Qendrore dhe në Republikën e Çadit (MINURCAT)”.

**Shpallur me dekretin nr.6178, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET
KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR TË KONTRIBUAR
NË BURIMET E MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NE REPUBLIKËN AFRIKANE
QENDRORE DHE ÇAD (MINURCAT)

Duke pasur parasysh se, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Republikën Afrikane Qendrore dhe Çad u krijua në vijim të rezolutës 1861 datë 14 janar 2009 të Këshillit të Sigurimit;

Duke pasur parasysh se, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (tani e tutje referuar si Qeveria) kanë rënë dakord për të kontribuar me trupa për Njësinë e Forcës Mbrojtëse për të ndihmuar MINURCAT në realizimin e mandatit të tij;

Duke pasur parasysh se Kombet e Bashkuara dhe Qeveria dëshirojnë të vendosin afate dhe kushte për kontributin,

tashmë, si pasojë, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria (tani e tutje bashkërisht të referuara si Palët) kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

1.Për qëllim të këtij memorandumit mirëkuptimi, do të zbatohen përkufizimet e aneksit F.

Neni 2
Dokumentacioni përbërës i Memorandumit të Mirëkuptimit

2.1 Ky dokument, përfshirë të gjitha anekset e tij, përbën tërësisht memorandumin e mirëkuptimit (tani e tutje referuar si MiM) ndërmjet Palëve për sigurimin e personelit në mbështetje të MINURCAT.

2.2 Aneksat

Aneksi A: Personeli

1. Kërkesat

2. Rimbursimi

3. Kushtet e përgjithshme për personelin

Shtojcë. Kutia e ushtarit – Kërkesë e bazuar në misione të veçanta

Aneksi B: Pajisje kryesore - Nuk aplikohet

Aneksi C: Vetëmbështetja – Nuk aplikohet

Aneksi D: Parimet e verifikimit dhe standardet e efektshmërisë për pajisjet kryesore të siguruara në bazë të marrëveshjeve të qirasë me ose pa shërbime shtesë: - Nuk aplikohet

Aneksi E: Parimet e verifikimit dhe standardet e efektshmërisë për pajisjet dytësore dhe mallrat e konsumit të siguruara në bazë të vetëmbështetjes- Nuk aplikohet

Aneksi F: Përcaktimet

Aneksi G: Udhëzime (aide-memoire) për Vendet Trupa-Kontribuese¹

Aneksi H: Standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara: Jemi Personeli Paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara

Neni 3

Qëllimi

3. Qëllimi i memorandumit aktual të mirëkuptimit është përcaktimi i termave dhe kushteve administrative, logjistike dhe financiare për të drejtuar personelin e siguruar nga ana e Qeverisë në mbështetje të MINURCAT dhe për të specifikuar standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara për personelin e siguruar nga Qeveria.

Neni 4

Zbatimi

4. Memorandumi aktual i Mirëkuptimit aplikohet së bashku me udhëzimet e Vendeve Trupa-Kontribuese.

Neni 5

Kontributi i Qeverisë

5.1 Qeveria ndihmon MINURCAT me personel sipas listës në aneksin A. Çdo personel mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

5.2 Qeveria ndihmon MINURCAT me pajisjet kryesore sipas aneksit B. Qeveria siguron që pajisjet kryesore dhe jokryesore të përmbushin standardet e efektshmërisë të përcaktuara në aneksin D gjatë kohëzgjatjes së dislokimit të tyre për MINURCAT. Çdo pajisje mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

5.3 Qeveria ndihmon MINURCAT me pajisje dytësore dhe mallra konsumi përsa i përket vetëmbështetjes siç përcaktohen në aneksin C. Qeveria siguron që pajisjet dytësore dhe mallrat e konsumit të përmbushin standardet e efektshmërisë të përcaktuara në aneksin E gjatë kohëzgjatjes së dislokimit të tyre për MINURCAT. Çdo pajisje mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

¹ Aneksi G është specifik për misionin dhe nuk është përfshirë në dokumentin aktual. Ai shpërndahet veçmas para dislokimit.

Neni 6

Rimbursimi dhe mbështetja e Kombeve të Bashkuara

6.1 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë përsa i përket personelit të vënë në dispozicion sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në bazë të normave të përcaktuara në nenin 2 të aneksit A.

6.2 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë për pajisjet kryesore të vëna në dispozicion sipas përcaktimeve të aneksit B. Rimbursimi i pajisjeve kryesore reduktohet në rast se pajisjet në fjalë nuk përmbushin standardet e kërkuara të efektshmërisë të përcaktuara në aneksin D apo në rast se reduktohet lista e pajisjeve.

6.3 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë për sigurimin e shërbimeve dhe mallrave për vetëmbështetje në bazë të normave dhe niveleve të përcaktuara në aneksin C. Rimbursimi për vetëmbështetjen reduktohet në rast se kontingjenti nuk përmbush standardet e kërkuara të efektshmërisë të përcaktuara në aneksin F apo në rast të reduktimit të vetëmbështetjes.

6.4 Rimbursimi për shpenzimet e trupave/policisë do të vazhdojë në bazë të normave të plota deri në largimin e personelit.

6.5 Rimbursimi për pajisjet kryesore do të jetë në fuqi me normë të plotë deri në datën e ndërprerjes së operacioneve nga ana e kontribuesit të trupave/policisë ose mbarimit të misionit dhe pas kësaj, të përlllogaritet me 50% të normës së rënë dakord në këtë memorandum mirëkuptimi deri në datën e largimit të pajisjeve.

6.6 Rimbursimi për plotësimin e nevojave të veta do të jetë në fuqi me normë të plotë deri në datën e ndërprerjes së operacioneve nga ana e kontribuesit të trupave/policisë ose mbarimit të misionit dhe pas kësaj, të reduktohet në 50% të normës së rënë dakord në këtë memorandum mirëkuptimi të përlllogaritur në bazë të forcës aktuale të mbetur të trupave/policisë së dislokuar deri kur i gjithë personeli i trupave/policisë të jenë larguar nga zona e misionit.

6.7 Kur Kombet e Bashkuara diskutojnë një kontratë për kthimin në atdhe të pajisjeve dhe transportuesi i tejkalon periudhën prej 14 ditësh mbas datës së pritshme të mbërritjes, kontribuesi i trupave/policisë do të rimbursohet nga ana e Kombeve të Bashkuara sipas normës së kontratës së qirasë pa shërbime shtesë nga data e pritshme e mbërritjes deri në datën aktuale të mbërritjes.

Neni 7

Kushtet e përgjithshme

7.1 Palët bien dakord që kontributi i Qeverisë, si dhe mbështetja nga ana e Kombeve të Bashkuara të drejtohet nga kushtet e përgjithshme të përcaktuara në anekset përkatëse.

Neni 7 bis

Standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara

7.2 Qeveria garanton se të gjithë anëtarëve të kontingjentit kombëtar të saj u është kërkuar të pajtohen me standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara të përcaktuara në aneksin H të memorandumit aktual të mirëkuptimit.

7.3 Qeveria garanton se të gjithë anëtarët e kontingjentit të saj kombëtar janë familiarizuar dhe kuptojnë plotësisht standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara. Për këtë qëllim, Qeveria, ndër të tjera, garanton që të gjithë anëtarët e kontingjentit të saj kombëtar të marrin kualifikimin e duhur dhe të efektshëm paradislokues mbi standardet në fjalë.

7.4 Kombet e Bashkuara vazhdojnë të sigurojnë për kontingjentet kombëtare në misione të veçanta materiale kualifikuese mbi standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta, dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, Kombet e Bashkuara ndërmarrin kualifikime induksioni të duhura dhe të efektshme dhe kualifikime gjatë funksionimit të misionit për të plotësuar kualifikimin paradislokues.

Neni 7 ter
Disiplina

7.5 Qeveria pranon se komandanti i kontingjentit të saj kombëtar është përgjegjës për disiplinën dhe rregullin e të gjithë anëtarëve gjatë funksionimit për MINURCAT. Qeveria, prandaj, garanton se komandantit të kontingjentit të saj kombëtar i është dhënë autoriteti i nevojshëm për të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme me qëllim ruajtjen e disiplinës dhe rregullit midis të gjithë anëtarëve të kontingjentit kombëtar duke siguruar pajtim me standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta, dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe detyrimet ndaj ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe vendore në përputhje me marrëveshjen e statusit të forcave.

7.6 Qeveria ndërmerr të garantojë, në varësi të çdo ligji të aplikueshëm kombëtar, se Komandanti i kontingjentit të saj kombëtar informon regullisht Komandantin e Forcës mbi çdo çështje serioze lidhur me disiplinën dhe rregullin e kontingjentit të tij kombëtar përfshirë çdo masë disiplinore të marrë për shkelje të standardeve të sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta të Kombeve të Bashkuara dhe për mosrespektim të ligjeve dhe rregulloreve vendore.

7.7 Qeveria garanton që komandanti i kontingjentit të saj kombëtar të marrë kualifikimin e duhur dhe të efektshëm paradislokues për kryerjen e duhur të detyrës lidhur me ruajtjen e disiplinës dhe rregullit të duhur midis anëtarëve të kontingjentit.

7.8 Kombet e Bashkuara asistojnë Qeverinë në përmbushjen e kërkesave të saj në bazë të paragrafit 3 më sipër duke organizuar sesione kualifikuese për komandantët mbas mbërritjes së tyre në misionin e Kombeve të Bashkuara mbi standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta dhe mbi ligjet dhe rregulloret vendore.

7.9 Qeveria përdor pagesat e saj të mbarëvajtjes për të siguruar mirëqenie dhe mundësi çlodhjeje të anëtarëve të kontingjentit të saj në mision.

Neni 7 quarter
Hetimet

7.10 Është e kuptueshme se Qeveria mban përgjegjësinë primare për hetimin e çdo akti të sjelljes së pahijshme ose sjelljes së pahijshme serioze të kryer nga një anëtar i kontingjentit të saj kombëtar.

7.11 Në rast se Qeveria ka arsye *prima facie* ku tregohet se një anëtar i kontingjentit të saj kombëtar ka kryer një veprim të sjelljes së pahijshme serioze, ajo njofton pa vonesë Kombet e Bashkuara dhe ia përcjell çështjen autoriteteve të saj kombëtare përkatëse për qëllime hetimore.

7.12 Në rastin kur Kombet e Bashkuara zotërojnë arsye *prima facie* që tregojnë se një anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë ka kryer një akt të sjelljes së pahijshme apo të sjelljes së pahijshme serioze, Kombet e Bashkuara njoftojnë pa vonesë Qeverinë. Nëse nevojitet që të ruhen të dhënat dhe kur Qeveria nuk realizon seancë për mbledhjen e të dhënave, Kombet e Bashkuara, në rastin e sjelljes së pahijshme serioze, sipas nevojës, kur Kombet e Bashkuara kanë informuar Qeverinë mbi pretendimin, mund të fillojnë një proces për mbledhje të dhënash mbi çështjen deri në momentin kur Qeveria të fillojë hetimet e saj. Është e kuptueshme në këtë pikë se çdo hetim i tillë për mbledhjen e të dhënave do të kryhet nga ana e zyrës hetimore përkatëse të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Zyrën Mbikëqyrëse të Shërbimeve të Brendshme në përputhje me rregulloret e organizatës. Çdo hetim i tillë paraprak për mbledhjen e të dhënave përfshin si pjesëtar të ekipit hetimor një përfaqësues të Qeverisë. Kombet e Bashkuara i sigurojnë Qeverisë pa vonesë një raport të plotë mbi hetimin paraprak të mbledhjes së të dhënave me kërkesën e kësaj të fundit.

7.13 Në rast se Qeveria nuk njofton Kombet e Bashkuara sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga koha e njoftimit nga ana e Kombeve të Bashkuara, se ajo do të ndërmarrë hetimin e saj mbi sjelljen e pahijshme serioze të pretenduar, Qeveria gjykohet jo e gatshme apo e paaftë për të kryer një hetim të tillë dhe Kombet e Bashkuara, sipas nevojës, mund të ndërmarrin një hetim administrativ mbi sjelljen e pahijshme serioze të pretenduar pa vonesë. Hetimi administrativ i realizuar nga ana e Kombeve të Bashkuara përsa i përket çdo anëtar i kontingjentit kombëtar respekton të drejtat ligjore të një procesi të duhur, të parashikuara për personin në fjalë nga ligji kombëtar dhe ndërkombëtar. Çdo hetim administrativ i tillë përfshin si pjesë të ekipit hetimor një përfaqësues të Qeverisë, në rast se Qeveria siguron një person të tillë. Në rast se Qeveria sidoqoftë vendos të fillojë hetimin e saj, Kombet e Bashkuara i vënë në dispozicion pa vonesë Qeverisë të gjithë dokumentacionin

në zotërim lidhur me çështjen. Në rastet kur plotësohet një hetim administrativ i Kombeve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara i sigurojnë Qeverisë të dhënat dhe konkluzionet e mbledhura gjatë procesit hetimor.

7.14 Në rastin e një hetimi administrativ të Kombeve të Bashkuara mbi sjelljen e pahijshme serioze nga ana e çdo anëtari të kontingjentit kombëtar, Qeveria bie dakord të udhëzojë komandantin e kontingjentit të saj që të bashkëveprojë dhe shkëmbejë dokumentacionin dhe të dhënat, në varësi të ligjeve ekzistuese kombëtare, përfshirë ligjet ushtarake. Qeveria gjithashtu ndërmerr, nëpërmjet komandantit të kontingjentit të saj, të udhëzojë anëtarët e kontingjentit të saj që të bashkëpunojnë me një hetim të tillë të Kombeve të Bashkuara, në varësi të ligjeve ekzistuese kombëtare, përfshirë ligjet ushtarake.

7.15 Kur Qeveria vendos të fillojë hetimin e saj dhe të përcaktojë apo dërgojë një ose më shumë zyrtarë për të hetuar mbi çështjen, Qeveria vë në dijeni menjëherë Kombet e Bashkuara mbi vendimin në fjalë përfshirë identitetet e zyrtarit apo zyrtarëve në fjalë (tani e tutje “Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare”).

7.16 Kombet e Bashkuara bien dakord të bashkëveprojnë plotësisht dhe të shkëmbejnë dokumentacionin dhe të dhënat me autoritetet përkatëse të Qeverisë, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare, i cili është duke hetuar një sjellje të pahijshme të mundshme ose sjellje të pahijshme serioze nga ana e çdo anëtari të kontingjentit kombëtar të Qeverisë.

7.17 Me kërkesë të Qeverisë, Kombet e Bashkuara bashkëveprojnë me autoritetet kompetente të saj, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare që është duke hetuar një sjellje të pahijshme të mundshme ose sjellje të pahijshme serioze nga ana e çdo anëtari të kontingjentit kombëtar të saj duke mbajtur lidhje me personelin tjetër kontribues të Qeverisë në mbështetje të MINURCAT, si dhe me autoritetet përkatëse në zonën e misionit me qëllim ofrimin e ndihmës për realizimin e hetimeve të tilla. Për këtë qëllim, Kombet e Bashkuara ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar pëlqimin e autoriteteve mikëpritëse. Autoritetet përkatëse të Qeverisë garantojnë se është siguruar nga autoritetet përkatëse të vendit mikëpritës autorizimi paraprak për të drejtën e përdorimit të një personi të dëmtuar apo dëshmitari i cili nuk është anëtar i kontingjentit kombëtar si dhe për mbledhjen apo sigurimin e të dhënave jo në zotërim apo nën kontrollin e kontingjentit kombëtar.

7.18 Në rastet kur Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare janë dërguar në zonat e misionit, ata drejtojnë hetimet. Roli i hetuesve të Kombeve të Bashkuara në çështje të tilla mbetet asistenca ndaj Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare, kur nevojitet, në realizimin e hetimeve të tyre për sa i përket p.sh., identifikimit dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve, regjistrimit të deklaratave të tyre, mbledhjes së të dhënave mjekoligjore dhe dokumentuese, dhe sigurimi i asistencës administrative si dhe logjistike.

7.19 Në varësi të ligjeve dhe rregulloreve të saj kombëtare, Qeveria vë në dispozicion të Kombeve të Bashkuara hetimet dhe konkluzionet e realizuara nga ana e autoriteteve të saj përkatëse, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare, mbi sjelljen e pahijshme të mundshme apo serioze të çdo anëtari të kontingjentit të saj kombëtar.

7.20 Kur Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare dërgohen në zonën e misionit, ata gëzojnë të njëjtin status ligjor sikur të ishin anëtarë të kontingjentit të tyre përkatës gjatë kohës kur ata ndodhen në zonën e misionit apo vendin pritës.

7.21 Me kërkesë të Qeverisë, Kombet e Bashkuara sigurojnë mbështetje administrative dhe logjistike ndaj Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare gjatë kohës kur ata ndodhen në zonën e misionit apo vendin pritës. Sekretari i Përgjithshëm, në përputhje me autoritetin e tij, siguron mbështetje financiare, sipas nevojës, për dislokimin e Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare, në situata ku prezenca e tyre kërkohet nga ana e Kombeve të Bashkuara, zakonisht Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse dhe kur mbështetja financiare kërkohet nga ana e Qeverisë. Kombet e Bashkuara do t'i kërkojnë Qeverisë të dislokojë Zyrtarë të Hetimeve Kombëtare për çështje komplekse dhe me rrezik të lartë dhe në rastet e sjelljes së pahijshme serioze. Ky paragraf nuk cenon të drejtën sovranë të Qeverisë për të hetuar çdo sjellje të pahijshme të anëtarëve të kontingjentit të saj.

Neni 7 quinquies

Ushtrimi i autoritetit nga ana e Qeverisë

7.22 Anëtarët ushtarakë dhe çdo civil, në varësi të ligjit ushtarak kombëtar të kontingjentit të siguruar nga Qeveria, i nënshtrohen autoritetit të veçantë të saj për sa i përket krimeve dhe shkeljeve që mund të kryhen prej tyre gjatë kohës së caktuar në njësinë ushtarake të MINURCAT. Qeveria garanton Kombet e Bashkuara se ajo ushtron autoritet të tillë për sa i përket krimeve dhe shkeljeve në fjalë.

7.23 Qeveria më tej garanton Kombet e Bashkuara se ajo ushtron autoritet disiplinor të tillë, sipas nevojës, për sa i përket të gjitha akteve të tjera të sjelljes së pahijshme të kryer nga çdo anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë gjatë kohës së caktuar në njësinë ushtarake të MINURCAT të cilat nuk klasifikohen si krime apo shkelje.

Neni 7 sexiens

Përgjegjësia

7.24 Nëse një hetim i Kombeve të Bashkuara apo një hetim i realizuar nga autoritetet kompetente të Qeverisë konkludon se dyshimet e sjelljes së pahijshme nga çdo anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë janë të bazuara, Qeveria garanton që çështja t'u përcillet autoriteteve përkatëse për të ndërmarrë veprimet e duhura. Qeveria bie dakord që autoritetet në fjalë të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë sikur të bëhej fjalë për të njëjtën shkelje apo kundërvajtje disiplinore tjetër në bazë të ligjeve dhe kodit disiplinor përkatës. Qeveria bie dakord të njoftojë rregullisht Sekretarin e Përgjithshëm mbi progresin e arritur përfshirë rezultatin e çështjes.

7.25 Nëse një hetim i Kombeve të Bashkuara, në përputhje me procedurat e duhura, ose hetimi i Qeverisë konkludon se dyshimet e mosveprimit nga ana e komandantit të kontingjentit

a) Për të bashkëpunuar me hetimin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 7 quarter, paragrafi 3 (b), duke u kuptuar se komandanti nuk do të kishte dështuar të bashkëpunonte thjesht po të vepronte në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tij kombëtare ose po të vepronte për hetimin e Qeverisë; ose

b) Për të ushtruar në mënyrë të efektshme urdhërin dhe kontrollin; ose

c) Për të raportuar menjëherë pranë autoriteteve përkatëse ose për të vepruar në lidhje me pretendimet për sjelljet e pahijshme të raportuara janë të bazuara, Qeveria garanton se çështja do t'u përcillet autoriteteve përkatëse për veprimet e duhura. Plotësimi i këtyre aspekteve përcaktohet në vlerësimin e performancës së komandantit të kontingjentit.

7.26 Qeveria kupton rëndësinë e zgjidhjes së çështjeve lidhur me pretendimet e atësisë ku përfshihet një anëtar i kontingjentit. Qeveria, aq sa e lejojnë ligjet e saj kombëtare, do të mundohet të ndihmojë në pretendime të tilla të paraqitura nga ana e Kombeve të Bashkuara duke i përcjellë ato pranë autoriteteve përkatëse kombëtare. Në rastin kur ligji kombëtar i Qeverisë nuk njeh kapacitetin ligjor të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur pretendime të tilla, atëherë pretendimet do t'i paraqiten Qeverisë nga ana e autoriteteve përkatëse të vendit pritës në përputhje me procedurat ekzistuese. Kombet e Bashkuara duhet të garantojnë që pretendime të tilla të shoqërohen me të dhëna të nevojshme përfundimtare si mostër e ADN-së së fëmijës kur parashikohet nga ligji kombëtar i Qeverisë.

7.27 Duke pasur në mendje detyrimin e komandantit të kontingjentit për të ruajtur disiplinën dhe rregullin e duhur, Kombet e Bashkuara, nëpërmjet Komandantit të Forcës garantojnë që kontingjenti të dislokohet në misionin e tij në përputhje me marrëveshjen ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë. Çdo ridislokim jashtë marrëveshjes do të realizohet me pëlqimin e Qeverisë apo komandantit të kontingjentit në përputhje me procedurat kombëtare ekzistuese.

Neni 8

Kushte të veçanta

8.1 Faktori i kushteve të ambientit: 2.60%

8.2 Faktori i intensitetit të operacioneve: 3.80%

8.3 Faktori i veprimit armiqësor/braktisjes së detyruar: 3.30%

8.4 Faktori rritës i transportimit: Distanca ndërmjet portit të hipjes në anije në vendin e origjinës dhe porti i hyrjes në zonën e misionit vlerësohet me (nuk aplikohet) ____ milje (____ kilometra). Faktori përcaktohet (nuk aplikohet) në përqindje të normave të rimbursimit.

8.5 Vendndodhjet e mëposhtme janë portet dhe vendet e hyrjes dhe daljes së origjinës të rena dakord me qëllim përgatitjen e transportimit të trupave/policisë dhe pajisjeve:

Trupat/policia:

Porti/Aeroporti i hyrjes/daljes: Tirana

(në vendin kontribues të trupave/policisë)

Porti/Aeroporti i hyrjes/daljes: N'Djamena

(në zonën e operacioneve)

Shënim. Trupat/policia mund të kthehen në një vend tjetër të përcaktuar nga kontribuesi i trupave/policisë, megjithatë, kostoja maksimale për Kombet e Bashkuara mbetet ajo e vendit të origjinës së rënë dakord. Kur trupat/policia largohen nga një port dalje të ndryshëm për alternativim, porti në fjalë nënkupton portin e hyrjes së rënë dakord për trupat/policinë në fjalë.

Pajisje: Vendi i origjinës: Nuk aplikohet

Porti i hipjes/zbritjes: Nuk aplikohet

(në vendin kontribues)

Ose

Kalimi i kufirit në hipje/zbritje: Nuk aplikohet

(në vendin kontribues kur nuk ka dalje në det ose lëvizje rrugore/hekurudhore)

Porti i hipjes/zbritjes: Nuk aplikohet

(në zonën e misionit)

Neni 9

Pretendime nga palët e treta

9. Kombet e Bashkuara janë përgjegjëse për të shqyrtuar çdo pretendim nga ana e palëve të treta kur humbja ose dëmtimi i pasurisë së tyre ose vdekja apo plagosja personale janë shkaktuar nga ana e personelit apo pajisjet e siguruara prej Qeverisë gjatë realizimit të shërbimeve ose nga çdo aktivitet apo operacion tjetër në bazë të këtij memorandumi mirëkuptimi. Megjithatë, nëse humbja, dëmtimi, vdekja dhe plagosja u shkaktuan për arsye të neglizhencës totale ose të sjelljes së pahijshme të qëllimshme të personelit të siguruar nga Qeveria, Qeveria mbetet përgjegjëse për pretendime të tilla.

Neni 10

Shpërblimi

10. Qeveria do të rimbursojë Kombet e Bashkuara për humbjen ose dëmtimin e pajisjeve dhe pasurisë në pronësi të Kombeve të Bashkuara të shkaktuara nga ana e personelit apo pajisjeve të Qeverisë nëse humbjet dhe dëmtimet në fjalë (a) ndodhën jashtë realizimit të shërbimeve apo çdo aktiviteti ose operacioni tjetër sipas këtij memorandumi mirëkuptimi, ose (b) lindën apo rezultuan si rrjedhojë e neglizhencës totale apo sjelljes së pahijshme të qëllimshme të personelit të Qeverisë.

Neni 11

Marrëveshje plotësuese

11. Palët mund të arrijnë marrëveshje plotësuese me shkrim mbi memorandumin aktual të mirëkuptimit.

Neni 12

Ndryshimet

12. Secila nga palët mund të ndërmarrë një rishikim të nivelit të kontributit që i nënshtrohet rimbursimit nga ana e Kombeve të Bashkuara ose nivelit të mbështetjes kombëtare për të garantuar pajtueshmëri me kërkesat operacionale të misionit dhe Qeverisë. Memorandumi aktual i mirëkuptimit mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje me shkrim të Qeverisë dhe Kombeve të Bashkuara.

Neni 13

Zgjidhja e konflikteve

13.1 MINURCAT krijon një mekanizëm brenda misionit për të diskutuar dhe zgjidhur, miqësisht me anë të diskutimit me frymën e bashkëpunimit, mosmarrëveshjet që dalin nga zbatimi i memorandumit aktual. Ky mekanizëm përbëhet nga dy nivele të zgjidhjes së konfliktit:

a) Niveli i parë. Drejtori/Shefi i Mbështetjes së Misionit, duke u konsultuar me Komandantin e Forcës/Komisionerin e Policisë dhe Komandantin e Kontingjentit do të mundohen të arrijnë një zgjidhje të konfliktit me anë të diskutimit;

b) Niveli i dytë: Në rast se negociatat e nivelit të parë nuk e zgjidhin konfliktin, një përfaqësues i misionit të përhershëm të shtetit anëtar dhe zëvendëssekretari i përgjithshëm, Departamenti i Mbështetjes Tokësore ose përfaqësuesi i tij/saj, me kërkesë të secilës palë, përpiqen të arrijnë një zgjidhje të konfliktit me anë të diskutimit.

13.2 Konfliktet të cilat nuk janë zgjidhur siç parashikohet në paragrafin 13.1 më sipër mund t'i paraqiten një pajtuesi apo ndërmjetësi të rënë dakord bashkërisht të emëruar nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në rast dështimi, konflikti mund të paraqitet për arbitrazh me kërkesë së secilës palë. Secila palë cakton një arbitër dhe dy arbitrat e caktuar në këtë mënyrë zgjedhin një të tretë si kryetar. Nëse brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa për arbitrat asnjë palë nuk ka caktuar një arbitër ose nëse brenda tridhjetë ditëve nga caktimi i dy arbitrave nuk është caktuar arbitri i tretë, secila palë mund t'i bëjë kërkesë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të caktuar një arbitër. Procedurat e arbitrazhit përcaktohen nga arbitrat dhe secila palë mbulon shpenzimet e veta. Vendimi i arbitrazhit përmban një deklaratë rreth arsyeve mbi të cilat është bazuar, dhe pranohet nga palët si vendim përfundimtar mbi konfliktin. Arbitrat nuk kanë autoritet të caktojnë dëmshpërblime mbi interesat ose dëmshpërblime ndëshkuese.

Neni 14 **Hyrja në fuqi**

14. Memorandumi aktual i mirëkuptimit hyn në fuqi më 15 mars 2009. Detyrimet financiare të Kombeve të Bashkuara në lidhje me rimbursimin e personelit fillojnë nga data e mbërritjes së personelit dhe pajisjeve në zonën e misionit dhe mbeten në fuqi deri në datën e largimit të personelit nga zona e misionit në bazë të planit të tërheqjes së rënë dakord ose në datën reale të largimit, kur vonesa i përket Kombeve të Bashkuara.

Neni 15 **Përfundimi i Marrëveshjes**

15. Modalitetet për përfundimin e marrëveshjes do të miratohen nga palët pas konsultimeve ndërmjet tyre.

Në dëshmi të kësaj, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria e _____ kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi.

Nënshkruar në Nju Jork, më _____, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Kombet e Bashkuara
Susana Malcorra
Zv. Sekretare e Përgjithshme
Për Mbështetjen Tokësore

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Adrian Neritani
Përfaqësues i Përhershëm
Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë
pranë Kombeve të Bashkuara

ANEKSI A
PERSONELI I SIGURUAR NGA QEVERIA

MINURCAT – Shqipëri

1. Kërkesa

1. Qeveria bie dakord të sigurojë personelin e mëposhtëm:

Për periudhën nga data 15 mars 2009

Njësia/nënnjësia	Numri i personelit	Kapaciteti
Shtabi i misionit		Oficerët e shtabit
Shtabi i kontingjentit		Komanda dhe kontrolli kombëtar
Skuadrilja e këmbësisë		Shtabi i kompanisë, kompania e këmbësisë së lehtë, kompania e zbulimit
Skuadrilja e xhenios		Niveli i forcës në ndërtim vertikal dhe horizontal
Skuadrilja e helikopterëve		Ekipi i mbështetjes së transportit ajror me ekuipazh ajror dhe stafi i mirëmbajtjes
Toga e transportit		Niveli i forcës dhe kapaciteti i transportimit të trupave
Grupi logjistik		Personeli përbërës, transporti, mirëmbajtja e pajisjeve, mbështetja mjekësore dhe financiare për kontingjentin
Toga e policisë ushtarake		Siguria e plotë dhe mbështetja e hetimit
Skuadra mbështetëse e informacionit ushtarak		Shërbime të lidhura me median, ndërlidhjen dhe përkthimin
Njësia e Mbrojtjes së Forcës	63	
Njësia e formuar e policisë		
Totali		

Shënim. Qeveria mund të sigurojë me shpenzimet e veta personel shtesë si element të komandës kombëtare (EKK) ose element mbështetës kombëtar (EMK). Nuk do të ketë pagesë për kostot e trupave/policisë, rotacion ose vetëmbështetje dhe asnjë përgjegjësi tjetër financiare për Kombet e Bashkuara për personelin e EMK.

2. Rimbursimi

2. Qeveria do të rimbursohet si më poshtë:

a) Kostot e trupave/policisë në normën prej 1,028 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti;
b) Veshje personale, ndihmë financiare për ingranazhe dhe pajisje në normën prej 68 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti. Kërkesa për pajimet e rekomanduara të trupave/policisë përfshihet në shtojcë;

c) Armatimet personale dhe municionet e stërvitjes në normën prej 5 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti;

d) Ndihmë financiare për specialistët në normën prej 303 \$ në muaj, për 25 për qind të forcës së trupave ënjësitë e logjistikës duhet të përfshihen në listë] dhe 10 për qind të forcës së trupave të njësive të këmbësisë, njësive të formuar të policisë, shtabit të forcës, shtabit të sektorit dhe njësive të tjera.

3. Personeli i kontingjentit do të marrë drejtpërdrejt nga misioni paqeruajtës një ndihmë financiare ditore prej 1.28 \$ plus një ndihmë financiare për leje pushimi prej 10.50 \$ në ditë për deri në 7 ditë leje të marra gjatë secilës periudhë gjashtëmujore.

3. Kushtet e përgjithshme për personelin

4. Qeveria do të garantojë që personeli i siguruar të përmbushë standardet e vendosura nga Kombet e Bashkuara për shërbimin pranë MINURCAT, ndër të tjera, në lidhje me gradën, përvojën, gjendjen shëndetësore, specializimin dhe njohurinë e gjuhëve të huaja. Personeli do të stërvitet me pajisjet me të cilat furnizohet kontingjenti dhe do të respektojë çdo politikë dhe procedurë që mund të parashtrahet nga Kombet e Bashkuara në lidhje me certifikatat mjekësore ose certifikata të tjera, vaksime, udhëtime, dërgesa, leje ose ndonjë të drejtë tjetër.

5. Gjatë periudhës në detyrë pranë MINURCAT, Qeveria do të jetë përgjegjëse për pagesën e çdo page, ndihme financiare dhe përfitimi që mund të jetë i kërkueshëm për personelin në përputhje me masat kombëtare.

6. Kombet e Bashkuara do t'i transmetojnë Qeverisë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me sigurimin e personelit, përfshirë çështjet e përgjegjësisë për humbje ose dëm ndaj pronës së Kombeve të Bashkuara dhe kërkesa kompensimi në lidhje me vdekjen, plagosjen ose sëmundjen që atribuohet nga shërbimi i Kombeve të Bashkuara dhe/ose humbja e pronës personale. Ankesat për vdekje dhe incidente që shkaktojnë paafësi për punë do të trajtohen në përputhje me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 52/177 të datës 18 dhjetor 1997. Udhëzimet për paraqitjen e ankesave që lindin nga vdekja dhe incidentet që shkaktojnë paafësi për punë jepen me hollësi në dokumentin A/52/369 të datës 17 shtator 1997.

7. Çdo personel mbi forcën e autorizuar në këtë memorandum mirëkuptimi përbën përgjegjësi kombëtare dhe nuk i nënshtrohet rimbursimit ose mbështetjes nga Kombet e Bashkuara. Ky personel mund të dislokohet pranë MINURCAT me miratimin paraprak të Kombeve të Bashkuara nëse gjykohet nga kontribuesi i trupave/policisë dhe Kombet e Bashkuara, që nevojitet për qëllime kombëtare, për shembull të operojë pajisjet e komunikimit për një pikë kontakti kombëtar në prapavijë. Ky personel do të jetë pjesë e kontingjentit dhe si i tillë gëzon statusin ligjor të anëtarëve të MINURCAT. Megjithatë, kontribuesi i trupave/policisë nuk do të marrë asnjë rimbursim në lidhje me këtë personel dhe Kombet e Bashkuara nuk do të pranojnë asnjë detyrim ose përgjegjësi financiare për këtë personel. Çdo mbështetje ose shërbim do të riankimohet nga rimbursimi në lidhje me kontribuesit e trupave/policisë.

8. Personeli i dislokuar, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara për detyra specifike të një kohëzgjatjeje të kufizuar, mund të mbulohet nga masa plotësuese për këtë memorandum mirëkuptimi, sipas nevojës.

9. Personeli kombëtar civil i siguruar nga Qeveria që shërben si pjesë e një grupi të formuar trupash/policie do të përfshihet me anëtarët e njësisë të grupeve të formuara të trupave/policisë për qëllim të këtij memorandum mirëkuptimi.

10. Masat e përgjithshme administrative dhe financiare të zbatueshme për sigurimin e personelit ushtarak dhe personelit tjetër do të jenë ato të parashtruara në udhëzimet për vendet kontribuese ndaj trupave në aneksin G.

Shtojca 1 e aneksit A

Pajimet e ushtarit- kërkesë e rekomanduar specifike për misionin

Me qëllim plotësimin e kërkesave minimale operationale më poshtë, paraqitet një listë e zërave të kërkuar. Kërkesat aktuale specifike për misionin do të diskutohen dhe miratohen gjatë bisedimeve të memorandumit të mirëkuptimit

Shembull i kërkesave për kontingjentin e këmbësores

Përshkrimi	Sasia
Artikuj të sigurisë dhe sigurisë personale: Helmetë luftimi	1
Veshje mbrojtëse (jelek antiplumb)	1
Artikuj uniforme: Xhaketë luftimi, peshë e lehtë	2
Këmishë me mëngë të gjata	2
Kanotiere	4
Pantallona luftimi, peshë e lehtë	2
Shami xhepi	6
Çizme për luftimin në shkretëtirë	1
Çorape vere	4
Mushama shiu	1
Pantallona të shkurtra	2
Mbathje	4
Llastiqe çorapësh	1
Peshqir dore	2
Artikuj pajisjesh: Dyshek fushor gjumi	1
Valixhe fushore	1
Furçë dhëmbësh	1

Thikë guzhine	1
Lugë	1
Pirun	1
Kusi	1
Kanë	2
Furçë pastrimi	1
Pagure uji	1
Rrjetë individuale mushkonjash	1
Fener ndriçues	1
Pajime mbijetese	1
Kutia e ndihmës së shpejtë	1
Veshje luftimi	1
Dorashka mjekësore njëpërdorimëshe	1
Busull	1
	1
Artikuj shtesë: Siç kërkohet dhe negociohet	1

Pajime policore- kërkesë e rekomanduar specifike për misionin

Me qëllim plotësimin e kërkesave minimale operationale më poshtë paraqitet një listë e zërave të kërkuar. Kërkesat aktuale specifike për misionin do të diskutohen dhe miratohen gjatë bisedimeve të memorandumit të mirëkuptimit.

Përshkrimi	Sasia
Artikuj të sigurisë dhe sigurisë personale: Helmetë me mbrojtëse fytyre	1
Parzmore e nivelit 4	1
Artikuj uniforme: Xhakëtë policore, peshë e lehtë	2
Këmishë me mëngë të gjata	2
Kanotiere	4
Pantallona policore, peshë e lehtë	2
Shami xhepi	6
Çizme shkretëtire	1
Çorape vere	4
Pantallona të shkurtra	2
Mbathje	4
Peshqir dore	2
Bilbil	1
Llastiqe çorapesh	1
Mushama shiu	1
Zëra të pajisjeve personale: Dyshek fushor gjumi	1
Valixhe fushore	1
Furçë dhëmbësh	1
Thikë guzhine	1
Lugë	1
Pirun	1
Tenxhere	1
Kanë	1
Furçë pastrimi	2
Pagure uji	1
Rrjetë individuale mushkonjash	1
Busull	1
Fener ndriçues	1

Pajime mbijetese	1
Kutia e ndihmës së shpejtë	1
Veshje luftimi	1
Dorashka mjekësore njëpërdorimëshe	1
Zëra pajisjesh: Shkop polici	1
Mburojë	1
Maskë gazi	1
Mbrojtës këmbësh/krahësh	1

ANEKSI F PËRKUFIZIME

1. Standardet e pranuar të gatishmërisë së Kombeve të Bashkuara nënkuptojnë që çdo njësi/formacion, anije, sistem armatimi ose pajisje duhet të jetë e aftë të përmbushë misionet ose funksionet për të cilat është organizuar ose planifikuar për të mundur arritjen e mandatit të misionit.

2. Artikujt e konsumueshëm nënkuptojnë furnizimet e një natyre të përgjithshme, të konsumuara rregullisht. Artikujt e konsumueshëm përfshijnë pajisjet e luftimit, rezervat e përgjithshme dhe teknike, rezervat e mbrojtjes, municioni/lëndët plasëse dhe artikujt e përdorimit bazë në mbështetje të pajisjeve kryesore si dhe në mbështetje të pajisjeve dytësore dhe personelit.

3. Kontingjent nënkupton të gjitha njësitë e formuara, personelin dhe pajisjet e kontribuesit të trupave/policiës të dislokuar në zonën e misionit sipas këtij memorandumit.

4. Pajisjet e zotëruara nga kontingjenti nënkuptojnë pajisjet kryesore dhe pajisjet dytësore dhe artikujt e konsumueshëm, të dislokuar dhe të operuar nga kontingjenti i kontribuesit të trupave/policiës në përmbushje të operacioneve paqeruajtëse.

5. Faktori i kushteve mjedisore nënkupton një faktor të zbatueshëm për normat e rimbursimit për pajisje kryesore dhe për vetëmbështetje për të marrë në konsideratë kostot e rritura të përballuara nga kontribuesi i trupave/policiës për kushte ekstreme malore, klimaterike dhe kushte të terrenit. Ky faktor zbatohet vetëm nën kushte të kostove të konsiderueshme shtesë të parashikuara për kontribuesin e trupave/policiës. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

6. Asgjësimi i municioneve të rrezikshme (EOD) nënkupton në kontekstin e EOD, zbulimin, identifikimin, vlerësimin në vend, bërjen të sigurt, përpunimin dhe asgjësimin përfundimtar të municionit të paplasur. Ai kryhet në emër të misionit nga një njësi e specialitetit si kapacitet force. Operacionet e forcës së EOD mund të kryejnë aktivitete në të gjithë ose në pjesë të zonës së misionit. Ai mund të përfshijë gjithashtu municion që është bërë i rrezikshëm nga dëmi ose përkeqësimi.

7. Asgjësimi i municioneve të rrezikshme (EOD) nënkupton, në kontekstin e vetëmbështetjes, EOD të kryer nga një njësi brenda zonës së tij të akomodimit/kampit.

8. Komandanti i Forcës nënkupton oficerin e emëruar nën varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, përgjegjës për të gjitha operacionet ushtarake brenda misionit.

9. Braktisje e detyruar nënkupton veprimet që rrjedhin nga një vendim i miratuar nga Komandanti i Forcës/Komisioneri i Policisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose një klauzolë në rregullat e angazhimit që rezulton në humbjen e kujdestarisë dhe kontrollit të pajisjeve dhe furnizimeve.

10. Vlera e përgjithshme e pranueshme e tregut (GFMV) nënkupton vlerësimet e pajisjeve për qëllime rimbursimi. Llogaritët si çmim i pranueshëm fillestar i blerjes plus çdo përmirësim kryesor kapital i përshtatur për inflacionin dhe i zbritur për ndonjë përdorim të mëparshëm ose vlerë zëvendësimi, cilado qoftë më e ulët. Vlera e përgjithshme e pranueshme e tregut përfshin të gjithë zërat e shoqëruar me pajisjet në përmbushjen e rolit të tyre operacional.

11. Qeveri nënkupton qeverinë e shtetit pjesëmarrës.

12. Kreu i Misionit nënkupton përfaqësuesin special/komandantin e emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm me miratimin e Këshillit të Sigurisë, përgjegjës për të gjitha aktivitetet e Kombeve të Bashkuara brenda misionit.

13. Veprim armiqësor nënkupton një incident nga veprimi (veprimet) e një ose më shumë ndërluftuesve që ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm negativ mbi personelin dhe/ose pajisjet e një kontribuesi trupash/policie. Aktivitete të ndryshme mund të karakterizohen si një veprim i vetëm armiqësor kur mund të kenë lidhje me njëra-tjetrën për çështje të interesit të përbashkët.

14. Faktori i braktisjes së detyruar/veprimit armiqësor nënkupton një faktor të zbatuar për secilën kategori të normave të vetëmbështetjes dhe ndaj pjesëve të këmbimit (ose gjysmës së normës së llogaritur të mirëmbajtjes) të normës së qirasë, përfshirë dhe shërbimet, për të kompensuar kontribuesin e trupave/policisë për humbje dhe dëm. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

15. Faktori rritës i transportimit nënkupton një faktor që duhet të mbulojë kostot e rritura të transportimit të pjesëve të këmbimit dhe artikujve të konsumueshëm sipas sistemit të qirasë, përfshirë dhe shërbimet ose qirasë për mirëmbajtjen në rritje prej 0,25 për qind të normës së qirasë për çdo distancë të plotë prej 800 kilometrash (500 milje), mbi 800 kilometrat e parë (500 milje) përgjatë një rruge dërgese midis portit të imbarkimit në vendin pritës dhe portit të hyrjes në zonën e misionit. Për vendet e mbyllura ose vendet ku pajisjet zhvendosen me rrugë tokësore ose hekurudhore për dhe në zonën e misionit, porti i hyrjes në zonën e misionit do të jetë një pikë kalimi kufitar e rënë dakord.

16. Furnizimi fillestar nënkupton një masë mbështetëse logjistike në një mision paqeruajtës përmes të cilës shteti kontribues siguron racione, ujë dhe POL për kontingjentin/njësinë mbi baza të rimbursueshme. Rimbursimi do të bëhet për kontribuesit e trupave/policisë pas paraqitjes së faturave. Normalisht, furnizimi fillestar për kontingjentët/njësitë kërkohet vetëm për dislokimin fillestar të kontingjentit/njesisë dhe për një periudhë të kufizuar (30-60 ditë) derisa Kombet e Bashkuara të jenë në gjendje t'i sigurojnë këto artikuj të konsumueshëm. Kërkesa për furnizimin fillestar të ujit, racionet dhe karburantin do të përcaktohet në udhëzimet TCC/PCC.

17. Faktori i kushteve të intensifikuara operacionale nënkupton një faktor të zbatueshëm për normat e rimbursimit për pajisjet kryesore dhe për normat e vetëmbështetjes për të kompensuar kontribuesin e trupave/policisë në lidhje me kostot e rritura që rrjedhin nga fusha veprimi të detyrës së caktuar, zgjatimi i zinxhirëve logjistikë, mosdisponueshmëria e riparimit komercial dhe lehtësirat e mbështetjes, si dhe rreziqet dhe kushtet e tjera operacionale. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

18. Marrja me qira e pajisjeve kryesore:

a) Qiraja, pa përfshirë shërbimet, nënkupton një sistem rimbursimi pajisjesh të zotëruara nga kontingjenti ku kontribuesi i trupave/policisë siguron pajisje për misionin dhe Kombet e Bashkuara marrin përsipër përgjegjësinë për mosdisponueshmërinë e burimeve të tyre ushtarake për interesin kombëtar të pajisjeve kryesore të dislokuara dhe pajisjeve dytësore shoqëruese;

b) Qiraja, përfshirë dhe shërbimet, nënkupton një sistem rimbursimi të zotëruar nga kontingjenti ku kontribuesi i trupave/policisë parashikon dhe merr përsipër përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe mbështetjen e artikujve kryesorë të dislokuar të pajisjeve së bashku me pajisjet dytësore shoqëruese. Kontribuesi i trupave/policisë ka të drejtën e rimbursimit për sigurimin e kësaj mbështetjeje.

19. Humbje ose dëm nënkupton një eliminim të përgjithshëm ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose furnizimeve që rrjedhin nga:

a) Një incident pa përfshirë sigurimet;

b) Veprime të një ose më shumë ndërluftuesve;

c) Një vendim të miratuar nga Komandanti i Forcës/Komisioneri i Policisë.

20. Norma e mirëmbajtjes nënkupton normën e rimbursimit për të kompensuar Qeverinë për kostot e mirëmbajtjes që përbëjnë pjesët e këmbimit, riparimin e kontraktuar dhe mirëmbajtjen e linjës së tretë dhe të katërt që kërkohet për të ruajtur operueshmërinë e zërave të pajisjeve në përputhje me standardet e specifikuar dhe kthimin e artikullit në gjendjen operacionale me kthimin nga zona e misionit. Kostot e personelit të përfshira në mirëmbajtjen e linjës së parë dhe të dytë përjashtohen nga norma kur rimbursohen veçmas. Norma përfshin një normë të rritur transportimi për të mbuluar kostot e përgjithshme të transportimit të pjesëve të këmbimit. Kjo normë përbën pjesë të normës së qirasë, përfshirë dhe shërbimet.

21. Pajisje kryesore nënkupton zëra kryesorë që kanë lidhje drejtpërdrejt me misionin e njësisë siç përcaktohet reciprokisht nga Kombet e Bashkuara dhe kontribuesi i trupave/policisë. Pajisjet kryesore

argumentohen ose me kategori, ose individualisht. Norma të veçanta rimbursimi zbatohen për secilën kategori zërash të pajisjeve kryesore. Këto norma përfshijnë rimbursimin për pajisje dytësore dhe artikuj të konsumueshëm në mbështetje të zërit të pajisjes kryesore.

22. Pajisje dytësore nënkuptojnë pajisjet në mbështetje të kontingjentëve si katering, akomodimi, komunikimi për jo-specialistët dhe aktivitete xhenioje dhe aktivitete të tjera që kanë lidhje me misionin. Argumentimi specifik i pajisjeve dytësore nuk kërkohet. Pajisjet dytësore ndahen në dy kategori: artikujt e caktuar për pajisjet kryesore mbështetëse dhe artikujt që drejtpërdrejt ose jo mbështesin personelin. Për pajisjet dytësore në lidhje me personelin, zbatohen normat e rimbursimit për vetëmbështetje.

23. Sjellja e pahijshme nënkupton çdo veprim ose mosveprim që është shkelje e standardeve të sjelljes së Kombeve të Bashkuara, rregullave dhe rregulloreve specifike për misionin ose detyrimet ndaj ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe lokale, në përputhje me marrëveshjen e statusit të forcave, ku ndikimi është jashtë kontingjentit kombëtar.

24. Rregulla dhe rregullore specifike për misionin nënkuptojnë, duke marrë parasysh paralajmërimet kombëtare, procedurat standarde operuese, direktivat dhe rregulloret e tjera, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Kreu i Misionit, Komandanti i Forcës ose Oficeri Kryeadministrator i misionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me standardet e sjelljes të Kombeve të Bashkuara; ato do të përbajnë informacion mbi ligjet dhe rregulloret e zbatueshme lokale dhe kombëtare.

25. Incident pa përfshirë sigurimet nënkupton një incident që rezulton nga një ngjarje aksidentale ose sjellje e neglizhuar, por nuk përfshin veprime që i atribuohen sjelljes së pahijshme me dashje ose neglizhencës serioze nga ana e operatorit/kujdestarit të pajisjes.

26. Municion operacional nënkupton municionin (përfshirë sistemet vetëmbrojtëse ajrore si municionet brizante ose shkrepiet infra të kuqe) që Kombet e Bashkuara dhe kontribuesit e trupave/policisë bien dakord të dislokojnë në zonën e misionit në mënyrë që të jenë lehtësisht të disponueshme për përdorim në rast nevojë. Municioni i harxhuar për stërvitje/trajnim operacional mbi standardet e pranuar të gatishmërisë të Kombeve të Bashkuara në varësinë dhe drejtimin specifik të Komandantit të Forcës në pritje të një kërkesë operacionale, do të konsiderohet municion operacional.

27. Komisioner Policie nënkupton oficerin e emëruar nën varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, përgjegjës për të gjitha operacionet policore brenda misionit.

28. Vizita para dislokimit janë vizita nga Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse/Departamenti i ekipeve të misionit në terren/mbështetjes në terren që përbëhen nga përfaqësues nga zona të përshtatshme funksionale (Shërbimi i Gjenerimit të Forcës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Terren, Drejtoria e Mbështetjes Logjistike etj.) në vende të shteteve anëtare. Ata zotohen të ndihmojnë shtetet anëtare të përgatisin kontingjentët e tyre për dislokim dhe të sigurojnë që kontribuesit e Shtetit Anëtar plotësojnë kërkesat operacionale të misionit dhe afatet kohore të dislokimit.

29. Hetime paraprake zbuluese nënkuptojnë ruajtjen e provave të nevojshme për të siguruar që një hetim kombëtar ose i Kombeve të Bashkuara mund të kryhet në mënyrë të suksesshme gjatë një faze të mëvonshme. Ndërsa ky hetim mund të përfshijë mbledhjen e deklaratave me shkrim, ai normalisht nuk do të përfshijë marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose personave të tjerë të përfshirë.

30. Vetëmbështetje nënkupton një koncept mbështetjeje logjistike për njësinë policore/kontingjentin e trupave në një mision paqeruajtës përmes të cilit shteti kontribues siguron mbështetje specifike ose logjistike për kontingjentin mbi baza të rimbursueshme.

31. Sjellje e pahijshme serioze është sjellje e pahijshme, duke përfshirë veprat penale që rezultojnë ose kanë të ngjarë të rezultojnë në humbje serioze, dëm ose plagosje/dëmtim të një individi ose një misioni. Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual përbëjnë sjellje të pahijshme serioze.

32. Abuzim seksual nënkupton ndërhyrjen fizike reale ose të kërcënuar të një natyre seksuale qoftë me forcë ose nën kushte të pabarabarta ose shtrënguese.

33. Shfrytëzim seksual nënkupton çdo abuzim real ose në tentativë të një pozicioni dobësie, pushteti diferencial ose besimi për qëllime seksuale, duke përfshirë, por jo kufizuar në përfitimet monetare, sociale ose politike nga shfrytëzimi seksual i një personi tjetër.

34. Pajisje unike nënkuptojnë çdo pajisje dytësore speciale ose artikull të konsumueshëm që nuk mbulohet në normat e mësipërme të vetëmbështetjes dhe do të trajtohet si pajisje unike.

Këto zëra do të trajtohen në një marrëveshje dypalëshe të një rasti të veçantë midis kontribuesit të trupave dhe Kombeve të Bashkuara.

ANEKSI H

NE JEMI PERSONELI I KOMBEVE TË BASHKUARA

Organizata e Kombeve të Bashkuara mishëron aspiratat për paqe të të gjithë popujve të botës.

Në këtë kontekst, Karta e Kombeve të Bashkuara kërkon që i gjithë personeli duhet të ruajë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes.

Ne do të respektojmë udhëzimet mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare për forcat që ndërmarrin operacione paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe pjesët e zbatueshme të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut si baza themelore e standardeve tona.

Ne, si personel paqeruajtës, përfaqësojmë Kombet e Bashkuara dhe jemi të pranishëm në vend për ta ndihmuar atë të rimëkëmbet nga trauma e një konflikti. Për pasojë, ne duhet të përgatitemi në mënyrë të vetëdijshme për të pranuar kufizimet e veçanta në jetën tonë publike dhe private, me qëllim që të kryejmë punën dhe të aspirojmë idealet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ne do të gëzojmë disa privilegje dhe imunitete të rregulluara përmes marrëveshjeve të negociuara ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe vendit pritës vetëm për qëllim të përmbushjes së detyrave tona paqeruajtëse. Pritshmëritë e komunitetit botëror dhe popullsisë lokale do të jenë të larta dhe veprimet tona, sjellja dhe të folurit do të monitorohen nga afër.

Ne gjithmonë:

- Do të sillemi në mënyrë profesionale dhe të disiplinuar;
- Do të jemi të përkushtuar për të arritur qëllimet e Kombeve të Bashkuara;
- Do të kuptojmë mandatin dhe misionin dhe do të pajtohemi me dispozitat e tyre;
- Do të respektojmë mjedisin e vendit pritës;
- Do të respektojmë ligjet, zakonet dhe praktikat lokale dhe do të informohemi për dhe do të respektojmë kulturën, fenë, traditat dhe çështjet gjinore;
- Do t'i trajtojmë banorët e vendit pritës me respekt, mirësjellje dhe nderim;
- Do të veprojmë me paanësi, ndershmëri dhe takt;
- Do të mbështesim dhe ndihmojmë të pafuqishmit, të sëmurët dhe të dobët;
- Do t'u bindemi eprorëve/drejtimesve tanë të Kombeve të Bashkuara dhe do të respektojmë zinxhirin e komandimit;
- Do të respektojmë të gjithë anëtarët e tjerë paqeruajtës të misionit pavarësisht nga statusi, grada, origjina etnike ose kombëtare, raca, gjinia ose besimi;
- Do të mbështesim dhe nxisim sjelljen e duhur mes personelit tonë paqeruajtës;
- Do të raportojmë në lidhje me të gjitha veprimet që përfshijnë shfrytëzim dhe abuzim seksual;
- Do të mbajmë gjithmonë veshje të përshtatshme dhe qëndrim personal ;
- Do të argumentojmë siç duhet të gjitha paratë dhe pronat që na janë dhënë neve, anëtarëve të misionit; dhe
- Do të kujdesemi për të gjitha pajisjet e Kombeve të Bashkuara të cilat na janë ngarkuar.

Ne asnjëherë:

- Nuk do të diskreditojmë Kombet e Bashkuara ose kombet tona me sjellje personale të papërshtatshme, mospërmbushje të detyrave tona ose abuzim me detyrën si personel paqeruajtës;
- Nuk do të marrim masa që mund të rrezikojnë misionin;
- Nuk do të abuzojmë me pije alkoolike, përdorim ose trafikim droge;
- Nuk do të bëjmë komunikime të paautorizuara me agjencitë e jashtme, përfshirë deklaratat e paautorizuara për shtyp;
- Nuk do të zbulojmë ose përdorim në mënyrë të papërshtatshme informacion të fituar përmes punësimit tonë;
- Nuk do të përdorim dhunë të panevojshme ose nuk do të kërcënojmë të burgosurit;
- Nuk do të kryejmë asnjë veprim që mund të çonte në dëm ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj anëtarëve të popullsisë lokale, veçanërisht grave dhe fëmijëve;
- Nuk do të kryejmë asnjë veprim që përfshin shfrytëzim dhe abuzim seksual, aktivitet seksual me fëmijë nën moshën 18 vjeç ose shkëmbim parash, punësim, mallra ose shërbime për seks;
- Nuk do të përfshihemi në lidhje seksuale që mund të cenonin paanësinë tonë ose mirëqenien e të tjerëve;
- Nuk do të jemi abuzues ose të paqytetëruar me njerëzit;

- Nuk do të dëmtojmë ose shpërdorojmë me dashje ndonjë pronë ose pajisje të Kombeve të Bashkuara;
 - Nuk do të përdorim një automjet në mënyrë të gabuar ose pa autorizim;
 - Nuk do të koleksionojmë suvenire të paautorizuara;
 - Nuk do të marrim pjesë në ndonjë aktivitet të paligjshëm, praktika korruptive ose të papërshtatshme ose nuk do të përpiqemi të përdorim detyrat tona për përfitim personal për të bërë ankesa të rreme ose për të pranuar përfitime për të cilat nuk kemi të drejtë.
- Ne kuptojmë se pasojat e mosveprimit tonë brenda këtyre udhëzimeve:
- Mund të ulin besimin në Kombet e Bashkuara;
 - Mund të rrezikojnë arritjen e misionit;
 - Mund të rrezikojnë statusin tonë dhe sigurinë si personel paqeruajtës; dhe
 - Mund të çojnë në masa administrative, disiplinore ose penale.

LIGJ

Nr.10 128, datë 11.5.2009

PËR TREGTINË ELEKTRONIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është vendosja e rregullave për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit, për mbrojtjen e personave pjesëmarrës, mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo e të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit, duke përcaktuar përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e shoqërisë së informacionit kundrejt personave fizikë a juridikë, përfitues të tyre, me përjashtim:

- a) të veprimeve noteriale ose veprimeve të tjera të ngjashme, që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik;
- b) të përfaqësimit të personave dhe mbrojtjen e interesave të tyre para gjykatave, si dhe në çdo organ, ku paraqitja e personit mund të bëhet nga të tretët, nëpërmjet akteve të përfaqësimit;
- c) të veprimtarisë me pagesë për pjesëmarrjen e lojtarëve në bastet, lotaritë, lojërat e fatit, lojërat elektronike, hipodromet dhe kazinotë.

2. Ky ligj nuk i shtrin efektet për marrëdhëniet juridike, që krijohen:

- a) në fushën e tatim-taksave;
- b) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- c) për çështjet, që lidhen me praktika e marrëveshje, të rregulluara nga ligji i konkurrencës.

Neni 3 Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Shërbimet e shoqërisë së informacionit” janë shërbimet, që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit.

Me fjalët:

i) “Në distancë” nënkuptohet se shërbimi ofrohet pa qenë e nevojshme që të dyja palët të jenë të pranishme në të njëjtën kohë.

ii) “Nëpërmjet mjeteve elektronike” nënkuptohet se shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, me anë të pajisjeve elektronike, për përpunimin (përfshirë edhe kompresimin numerik) dhe ruajtjen e të dhënave.

Dërgimi, transmetimi dhe marrja e plotë bëhen nëpërmjet kabllave, radiovalëve, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike.

iii) “Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit” nënkuptohet se shërbimet ofrohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave, me kërkesë individuale të marrësit.

Shërbimet e shoqërisë së informacionit përfshijnë, në veçanti, shitjen e mallrave e të shërbimeve, shërbimet e aksesit të informacionit apo të reklamave në internet e të aksesit në shërbimet e rrjeteve publike të komunikimit, transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të marrësit në rrjetin publik të komunikimeve.

b) “Ofruesi i shërbimit” është çdo person fizik ose juridik, që ofron një shërbim të shoqërisë së informacionit.

c) “Ofrues shërbimi të themeluar” është personi fizik apo juridik, që ofron shërbimin dhe që ushtron veprimtarinë ekonomike në mënyrë të përhershme e që ka një seli të vet të regjistruar. Ekzistenca dhe përdorimi i mjeteve teknike dhe i teknologjive të kërkuara për ofrimin e shërbimit nuk përbën, në vetvete, themelimin të ofruesit.

ç) “Marrësi i shërbimit” çdo person fizik ose juridik, i cili, për qëllime profesionale a të ndryshme, në mënyrë të veçantë, për qëllime të kërimit të informacionit dhe bërjen e tij të aksesueshëm, përdor një shërbim të shoqërisë së informacionit.

d) “Ndërmjetës i shërbimit” është çdo person fizik ose juridik, i cili mundëson transmetimin e mesazheve apo të dokumenteve të ofruesit të shërbimit të shoqërisë së informacionit tek të tretët, apo që çon mesazhe a informacione nga marrësit e shërbimit dhe të mallrave nga të tretët tek ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit.

dh) “Konsumator” është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime, të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin ose ushtrimin e profesionit.

e) “Komunikimi tregtar” është çdo mënyrë komunikimi e dizenuar për nxitjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të mallrave, të shërbimeve ose imazhin e një tregtari a shoqërie tregtare, organizate jofitimprurëse apo personi që kryen një veprimtari tregtare, industriale a zejtarie ose ushtron një profesion të rregulluar.

Nuk janë komunikime tregtare, në kuptim të këtij ligji:

i) informacionet, që lejojnë akses të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e shoqërisë, të organizatës ose personit, në veçanti zotërimi i domenit ose adresa e postës elektronike.

ii) komunikimet, që lidhen me mallra, shërbime ose me imazhin e tregtarit a të shoqërisë tregtare, organizatës jofitimprurëse ose personit, të grumbulluara në mënyrë të pavarur, në ato raste kur kjo është bërë pa kosto financiare.

ë) “Profesione të rregulluara” janë të gjitha ato profesione, mënyra e ushtrimit e të cilave është rregulluar me ligj të veçantë.

f) “Tregti elektronike” është kryerja nga subjektet e këtij ligji të një veprimtarie, nëpërmjet shkëmbimit të dokumenteve elektronike, për tregtimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve.

Neni 4
Parime të përgjithshme

1. Veprimet tregtare, të kryera në rrugë elektronike, bazohen në parimet e barazisë së pjesëmarrësve, të vullnetit të lirë, lirisë kontraktuale, zhvillimit të lirë të veprimtarisë sipërmarrëse, si dhe në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në fushën e tregtisë elektronike, palët pjesëmarrëse nuk mund të vendosin kufizime për blerjen dhe përmbushjen e të drejtave e të detyrimeve të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 5
Zbatimi i ligjit

1. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, me seli në Republikën e Shqipërisë, e ushtron veprimtarinë në mënyrë të veçantë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, për të ofruar shërbimet e veta në distancë, siguron që këto shërbime:

- a) të mos cenojnë të drejtat e njeriut;
- b) të garantojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe të investitorëve, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) të sigurojnë mbrojtjen e minorenëve;
- ç) të vendosin masa mbrojtëse për mosndërhyrjen në shërbimet e tij dhe mospërdorimin e tyre për qëllime kriminale;
- d) të ofrohen për të gjithë klientët njëjloj, pa dallime ndërmjet sekseve, racave, besimit apo bindjeve të personave që i përfitojnë ato;
- dh) të mos cenojnë sigurinë kombëtare dhe sigurinë e publikut;
- e) të mos cenojnë shëndetin e klientëve;
- ë) të ofrohen, në çdo rast, me pëlqimin paraprak të përfituesit të shërbimit.

KREU II
E DREJTA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Neni 6
E drejta e ofrimit të shërbimit

1. Çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve, ka të drejtë të ofrojë shërbime të shoqërisë së informacionit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, pa u pajisur paraprakisht me autorizim të veçantë apo ndonjë dokument tjetër që ka një efekt të ngjashëm me to.

2. Nuk i nënshtrohen parashikimeve të pikës 1 të këtij neni:

- a) ofruesit e shërbimeve, të cilët kanë detyrimin për t'u pajisur me autorizim, sipas ligjit "Për komunikimet elektronike".
- b) ofruesit e shërbimeve financiare ose të sigurimeve, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbështetje të ligjeve, që rregullojnë mënyrën e organizimit e të ushtrimit të veprimtarisë për këto shërbime.

Neni 7
Detyrimi për informacion të përgjithshëm

1. Ofruesi i shërbimit në ushtrimin e veprimtarisë siguron për marrësit e shërbimit dhe për autoritetet përkatëse informacion, të paktën, për:

- a) emrin tregtar të ofruesit të shërbimit dhe, nëse nuk ka të tillë, emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë;

b) adresën e vendit, në të cilën është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit;

c) adresën e postës elektronike apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit;

ç) të dhënat e regjistrimit në regjistrin tregtar të ofruesit të shërbimit, sidomos numrin unik të identifikimit të personit;

d) të dhëna të veçanta të autoritetit përgjegjës mbikëqyrës, kur veprimtaria e ofruesit të shërbimit është objekt i ushtrimit të saj nëpërmjet pajisjes së tij me autorizim të veçantë;

dh) profesionet e rregulluara, duke treguar edhe:

i) entin publik profesional ose institucionin e ngjashëm me të, ku ofruesi i shërbimit është i regjistruar;

ii) titullin profesional dhe shtetin e lëshimit apo të fitimit të tij;

iii) referimin për rregullat, që rregullojnë profesionin dhe juridiksionin e zbatuar në shtetin e krijimit të tij, si dhe mjetet për informim për to;

e) numrin unik të identifikimit të subjektit apo NIPT-in.

2. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit jep informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në mënyrë të qartë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm, për mallrat apo shërbimet, që ai ofron ose parashikon të ofrojë në të ardhmen, veçanërisht për çmimet. Informacioni duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm, se çmimi i ofruar prej tij është përfundimtar dhe se në të janë përfshirë tatimi e kostot e transportit apo të dërgimit të tij deri në destinacionin përfundimtar, të përfituesit apo të marrësit.

3. Në çdo rast, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit është i detyruar që, në informacionet që jep, veç parashikimeve të këtij ligji, të respektojë edhe parashikimet e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”.

KREU III KOMUNIKIMET TREGTARE

Neni 8

Kushtet për ofrimin e informacionit

Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit në komunikimet tregtare, të cilat janë pjesë apo përbëjnë një shërbim të shoqërisë së informacionit, siguron se këto komunikime plotësojnë të paktën kushtet e mëposhtme:

a) janë qartësisht të identifikueshme nga të tretët si komunikime tregtare;

b) bëjnë të mundur identifikimin e qartë të personit fizik ose juridik, në emër dhe për llogari të të cilit janë bërë këto komunikime tregtare;

c) në rastin e ofertave promociionale, që sjellin si pasojë uljen e çmimit, fitimin e ndonjë çmimi apo të dhuratave të lejuara, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të ketë të identifikuar qartë të dhënat e mësipërme, si dhe duhet të paraqesë në mënyrë të qartë, lehtësisht të arritshme dhe pa dyshim, kushtet që duhen plotësuar për kualifikim;

ç) në rastin e konkurseve apo të lojërave promociionale, nëse këto janë të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit duhet t'i ketë të identifikuar qartë ato si të tilla, si dhe të paraqesë për të tretët, në mënyrë të qartë, lehtësisht të arritshme dhe pa asnjë dyshim, kushtet për pjesëmarrjen e tyre.

Neni 9

Komunikimet tregtare të pakërkuara

1. Komunikimet tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike janë të lejuara në rast se plotësojnë, përveç kriterëve të përcaktuara me këtë ligj, edhe kushtet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Komunikimet tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike, në ato raste kur sipas legjislacionit janë të lejuara, duhet të identifikohen qartë dhe pa dyshim si të tilla, që në çastin fillestar të marrjes së tyre prej marrësit.

3. Ofruesit e shërbimeve, që ofrojnë komunikime tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike, janë të detyruar të kontrollojnë rregullisht dhe të respektojnë regjistrin e përjashtimeve, ku, me cilësinë e personave që nuk dëshirojnë marrjen e këtyre komunikimeve, regjistrojnë personat, të cilëve u është drejtuar, por që nuk kanë dëshirë të marrin komunikime të tilla tregtare. Ofruesi i shërbimit, që ka pasur dijeni për mosdëshirën e personave për të marrë komunikime të tilla dhe nuk i ka regjistruar si të tillë, është i detyruar të shpërblejë dëmin e ardhur, si pasojë e këtij mosveprimi.

Neni 10

Profesionet e rregulluara

1. Komunikimet tregtare, që janë pjesë apo përbëjnë një shërbim të shoqërisë së informacionit, të ofruar nga anëtarët e profesioneve të rregulluara, u përmbahen rregullave për ushtrimin e profesionit, veçanërisht për pavarësinë, dinjitetin, nderin e profesionit, sekretin profesional dhe ndershmërinë kundrejt klientit dhe anëtarëve të tjerë të profesionit.

2. Qëllimet e komunikimeve tregtare, që ofrohen nga ana e profesioneve të rregulluara, parashikohen në kodet e sjelljes apo të etikës së tyre, të cilat përfshijnë llojin e informacionit, që mund të jepet për qëllime të komunikimeve tregtare, sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU IV

KONTRATAT E LIDHURA NËPËRMJET MJETEVE ELEKTRONIKE

Neni 11

Kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e kontratave

1. Kontratat e lidhura përmes mjeteve elektronike quhen kontrata në formë elektronike.

2. Propozimi dhe pranimi i ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, që është forma elektronike e tyre. Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës, të parashikuar nga Kodi Civil dhe kërkesat e veçanta, të parashikuara në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

Neni 12

Kontratat e përjashtuara nga fusha e veprimit të këtij ligji

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e mëposhtme:

- a) për kontratat e lidhura për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta mbi sendet e paluajtshme, përveç kontratës së qirasë për pasuri të paluajtshme me afat deri në 9 vjet;
- b) për kontratat, që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike dhe profesioneve, që ushtrojnë apo japin një shërbim publik;
- c) për kontratat e garancisë dhe kolaterali i letrave me vlerë, i dhënë nga persona, që veprojnë për qëllime të ndryshme nga ato të biznesit, tregtisë apo profesionit të tyre;
- ç) për kontratat e parashikuara nga Kodi i Familjes dhe veprimet juridike, të parashikuara nga Kodi Civil pjesa III titulli III “Trashëgimia me testament”;
- d) për shërbimet financiare ose shërbimet e sigurimit, për të cilat zbatohet marketingu në distancë.

Neni 13

Informacioni që duhet ofruar

1. Ofruesi i mallit dhe/ose shërbimit jep informacion të plotë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe përpara se të bëhet kërkesa nga marrësi i shërbimit, për:

- a) hapat e ndryshëm proceduralë, që do të ndiqen për lidhjen e kontratës;
- b) kushtet kontraktore të palëve;
- c) mënyrat teknike për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, përpara paraqitjes së kërkesës/porosisë;

c) gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës;
d) faktin nëse kontrata e lidhur do të arkivohet nga ofruesi i shërbimit dhe nëse do të ketë akses te kjo kontratë.

2. Në rastet kur palët, që nuk janë konsumatorë, bien dakord ndryshe nga sa kërkohet në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit tregon Kodin e Etikës, ku përshkruhet edhe mënyra e konsultimit të këtij kodi në formë elektronike.

3. Termat e kontratës dhe kushtet e përgjithshme të saj i jepen marrësit në atë mënyrë, që ai të mund t'i ruajë, përdorë dhe riprodhojë ato për qëllimet e kësaj marrëdhënieje.

4. Pikat 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen për kontratat e lidhura ekskluzivisht nëpërmjet shkëmbimit të postës elektronike apo komunikimeve individuale, ekuivalente.

Neni 14

Lidhja e kontratës

1. Ofruesi i shërbimit jep një fletëpërmbledhje të kushteve, të përgjithshme e të veçanta, që i aplikohen kontratës, si dhe njofton pa vonesë për marrjen e porosisë nga marrësi i shërbimit nëpërmjet mjeteve elektronike, përveç rasteve kur palët jokonsumatore bien dakord ndryshe.

2. Kontrata elektronike quhet e lidhur kur ofruesi merr një mesazh elektronik, që përmban deklarinimin e marrjes së konfirmimit dhe pranimin e ofertës.

3. Propozimi dhe pranimi i ofertës, të bërë nga palët në marrëdhënien juridike, që lind për shkak të tregtisë elektronike ndërmjet tyre, vlerësohen se janë marrë, kur palët, paraprakisht, t'i kenë provuar njëra-tjetrës se janë në gjendje t'i marrin ato në rrugë elektronike. Në këtë rast, parashikimet e Kodit Civil për pranimin apo refuzimin e ofertës, të parashikuara në kushtet e përgjithshme të kontratave, janë të zbatueshme edhe për këtë qëllim.

KREU V

PËRJASHTIMI NGA PËRGJEGJËSITË PËR OFRUESIN E SHËRBIMIT

Neni 15

Përgjashtimi nga përgjegjësitë për ofruesin e shërbimit, që vepron si ndërmjetës

1. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, kur vepron si ndërmjetës për transmetimin apo mundësimin e transmetimit të mesazheve elektronike, që janë paraqitur nga përdoruesi i shërbimeve, nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar, nëse ofruesi:

- a) nuk inicion transmetimin;
- b) nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit të transferuar;
- c) nuk zgjedh marrësin e transmetimit.

2. Veprimet e transmetimit dhe të ofrimit të aksesit, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshijnë ruajtjen automatike, të menjëhershme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar vetëm për përcjelljen e transmetimit në një rrjet komunikimi, duke siguruar ruajtjen e informacionit për aq kohë sa nevojitet.

Neni 16

Ruajtja e përkohshme e informacionit (Caching)

Gjatë transmetimit të informacionit në rrjetin e komunikimit, ofruesi i shërbimit, që ofron transmetimin e informacionit, nuk është përgjegjës për ruajtjen e përkohshme, të ndërmjetshme dhe automatike, të kryer vetëm për rritjen e efikasitetit të transmetimit të informacionit të marrësit e tjerë të shërbimit, në bazë të kërkesës së tyre, nëse ofertuesi:

- a) nuk modifikon informacionin;
- b) përmbush/vepron, në përputhje me kushtet e aksesit të informacionit;
- c) përmbush/vepron në përputhje me rregullat për përditësimin e informacionit, në një mënyrë të specifikuar, të mirënjohur dhe të përdorur gjerësisht;

ç) nuk ndërhyt nëpërmjet përdorimit të ligjshëm të teknologjisë së njohur dhe të përdorur gjerësisht nga industria e komunikimeve elektronike, për marrjen e të dhënave mbi përdorimin e informacionit;

d) vepron me shpejtësi, për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacionin e ruajtur, pasi njihet me faktin se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti, aksesin në të është çaktivizuar ose organet përgjegjëse kanë urdhëruar heqjen apo çaktivizimin.

Neni 17

Përgjegjësitë në aktivizimin e memorizimit të informacionit (Hosting)

1. Kur shërbimi i shoqërisë së informacionit ofrohet për ruajtjen e informacionit të paraqitur/siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi:

a) nuk ka ose nuk mund të ketë dijeni për veprimtarinë e paligjshme të marrësit ose të përmbajtjes së informacionit dhe, për sa u përket pretendimeve për dëme, nuk është në dijeni të fakteve a rrethanave prej të cilave rrjedh aktiviteti apo informacioni i paligjshëm;

b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur marrësi i shërbimit vepron në emër ose në kontrollin e ofruesit të shërbimit.

Neni 18

Mjetet e kërkimit të informacionit

Ofruesit e shërbimit, të cilët krijojnë, nëpërmjet mjeteve elektronike, akses në informacion për palët e treta, nuk janë përgjegjës për këtë informacion, nëse:

a) nuk kanë dijeni ose nuk mund të kenë dijeni për veprimtarinë e paligjshme të marrësit ose rreth të dhënave që përmban informacioni;

b) me vënien në dijeni të faktit për veprimtari të paligjshme ose të të dhënave, heqin a çaktivizojnë aksesin për këto të dhëna.

Neni 19

Ndërprerja ose parandalimi i shkeljeve

Pavarësisht nga sa parashikohet në dispozitat e këtij ligji, në veçanti në nenet 15, 16, 17 e 18, ofruesi i shërbimit është i detyruar të ndërpresë ose të parandalojë një shkelje, nëse kjo kërkohet nga gjykata ose nga autoritetet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Detyrimet e ofruesit të shërbimit

1. Ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, që janë objekt i këtij kreu, nuk kanë detyrim për mbikëqyrjen e informacionit, që ata transmetojnë ose ruajnë, si dhe për kërkimin e fakteve apo të situatave, që tregojnë një veprimtari të paligjshme.

2. Ofruesit e shërbimit të shoqërisë së informacionit njoftojnë menjëherë autoritetet përgjegjëse, nëse kanë dyshime të arsyeshme se përdoruesit e shërbimeve:

a) janë duke kryer veprimtari të paligjshme;

b) kanë paraqitur informacion ilegal.

3. Ofruesit e shërbimeve u paraqesin organeve përgjegjëse, në bazë të kërkesës së tyre dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjithë informacionin, që mundëson identifikimin e marrësit të këtyre shërbimeve.

KREU VI AUTORITETET MBIKËQYRËSE DHE SANKSIONET

Neni 21 Autoritetet mbikëqyrëse

1. Për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj, nga ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj, për mbrojtjen e konsumatorëve, ngarkohen Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit”.
3. Për qëllime të mbikëqyrjes, ofruesit e shërbimit të shoqërisë së informacionit u ofrojnë personave të autorizuar akses në pajisjet kompjuterike dhe japin, pa vonesë, informacionin dhe dokumentet e transmetuara, që kanë lidhje me subjektin e mbikëqyrjes.

Neni 22 Sanksionet

1. Një person juridik, ofrues i shërbimit të shoqërisë së informacionit, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë, për rastet e mëposhtme:
 - a) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm (neni 7);
 - b) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm për komunikimet tregtare (neni 8);
 - c) shkelje të detyrimit për sigurimin e aksesit për lidhjen e kontratës (neni 13 pika 1);
 - ç) mosrespektim të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji për mosdhënien e aksesit për marrësin e shërbimit, në mënyrë që t'i ruajë, përdorë dhe riprodhojë ato;
 - d) shkelje të detyrimeve të pikave 2 e 3 të nenit 20 të këtij ligji;
 - dh) mosdhënie akses në pajisjet kompjuterike dhe të informacionit për personat e autorizuar, sipas pikës 3 të nenit 21 të këtij ligji.
2. Nëse shkeljet e mësipërme janë kryer nga persona fizikë, ofrues të shërbimit të shoqërisë së informacionit, në këtë rast ata dënohen me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Shkeljet e parashikuara nga ky ligj, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe, sipas fushës së tyre të veprimit, autoritetet mbikëqyrëse vendosin gjobat, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 23 Ankimi

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij.

Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, që rrjedhin nga hyrja në marrëdhënie me njëri-tjetrin, për shkak të ofrimit dhe të pranimit të shërbimeve në distancë, zgjidhen nga gjykata e arbitrazhit, sipas klauzolave të arbitrazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rast mungese të marrëveshjes për arbitrazh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata e rrethit gjyqësor.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6179, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 129, datë 11.5.2009

PËR GJENDJEN CIVILE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Gjendja civile” është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.

2. “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

3. “Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile” është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në arkivin e degës të gjendjes civile në qark.

4. “Përbërës të gjendjes civile” janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

5. “Përbërës të prezumuar” janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin, që vërtetohet ndryshe.

6. “Dokumente të arkivuara” është i gjithë dokumentacioni, që mbahet dhe përdoret nga zyra e degës së gjendjes civile në qark.

7. “Emra të papërshtatshëm” janë emrat me karakter fyes, imoral ose racist, të përcaktuar të tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

8. “Ministri”/“Ministria” është ministri/ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 3

Karakteret personal i të dhënave

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përket këto

të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.

3. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej institucioneve dhe organeve të ndryshme, në përputhje me përmbledhësen e miratuar prej tij dhe komisionerit të të dhënave personale. Përmbledhësja përcakton llojin dhe sasinë e informacionit, që mund t'u jepet institucioneve dhe organeve kërkuese, duke pasur parasysh ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tyre, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Vlera juridike e të dhënave

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo akt dhe dokument, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon, në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

Neni 5

Papajtueshmëria e veprimeve

Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

KREU II

GJENDJA CIVILE

Neni 6

Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, kombësia, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.

3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7

Numri i identitetit

1. Numri i identitetit është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.

2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, kombësia dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9

Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 11

Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera

Birësimi, shtetësia, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 12

Përbërës që vërtetohen nga burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike, shtetërore e private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

Neni 13

Gjendja civile e personave

1. Gjendja civile e një personi mund të jetë:
 - a) beqar/e;
 - b) i/e martuar;
 - c) i/e ve;
 - ç) i/e shkurorëzuar.
2. "Beqar/e" është shtetasi, i cili nuk ka kryer akt martese.
3. "I/e martuar" është shtetasi i lidhur me akt martese.
4. "I/e ve" është shtetasi pas vdekjes së bashkëshortes/bashkëshortit, me të cilën/cilin ishte i/e lidhur me akt martese.
5. "I/e shkurorëzuar" është shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor.

KREU III

DEKLARIMI DHE REGJISTRIMI I VENDBANIMIT

Neni 14

Deklarimi i vendbanimit

1. Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike.

2. Shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij.

Neni 15

Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit

1. Regjistrimi fillestar i vendbanimit/adresës së banesës, sipas nenit 14 të këtij ligji, si dhe ndryshimi i vendbanimit/adresës së banesës, si rregull, bëhet në zyrën e gjendjes civile bashki/komunë që ka në juridiksion territorial vendbanimin apo banesën e deklaruar.

2. Nëse një shtetas ka më shumë se një banesë për përdorim, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, ai duhet të deklarojë banesën, në të cilën ka vendbanimin e tij. Shtetasit nuk mund të deklarojnë njëherazi më shumë se një vendbanim.

3. Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit.

4. Rregullat e veprimeve për pasqyrimin e regjistrimit dhe ndryshimit të vendbanimit të shtetasve, përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 16

E drejta për deklarimin e vendbanimit

1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes.

2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.

3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

Neni 17

Pranimi në një vendbanim tjetër

1. Një shtetas apo një familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një shtetasi apo familjeje tjetër, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe kur zotërojnë një kontratë apo kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetasi që zotëron titull të ligjshëm pronësie ose përdorimi të banesës, deklaroon në zyrën e gjendjes civile pranimin e shtetasit apo familjes ardhëse në atë vendbanim.

Neni 18

Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë

1. Për shtetasit që:
 - a) kryejnë shërbimin ushtarak apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda territorit të njësisë së Forcave të Armatosura;
 - b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;
 - c) qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, me qëllim kurimin afatgjatë;dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.
2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.
3. Kur përfundon qëndrimi i shtetasve në një nga institucionet e përcaktuara në këtë nen, institucioni përkatës njofton zyrën e gjendjes civile brenda juridiksionit të tij territorial, në lidhje me këtë fakt, brenda 5 ditëve. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile.
4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e njoftimit nga ana e institucioneve për kategoritë e shtetasve të përcaktuar në këtë nen.

Neni 19

Afati i deklarimit të ndryshimit të vendbanimit për arsye pune ose arsimimi

1. Shtetasit që për arsye të kryerjes së detyrave shtetërore apo për shkak punësimi janë të detyruar të jetojnë zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje apo për më shumë se gjashtë muaj, gjatë një viti kalendarik, në një vendbanim të ndryshëm me atë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile, janë të detyruar të deklarojnë vendbanimin e ri brenda 30 ditëve nga ardhja në atë vendbanim, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri.
2. Rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për arsye arsimimi, kur ata ndjekin programe shkollore apo universitare në sistemin me shkëputje nga puna dhe kur programi i plotë akademik është më i gjatë se 1 vit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit që banojnë apo regjistrojnë vendbanimin e tyre brenda territorit të qarkut apo në rrethet fqinje me atë, në të cilin ndodhet adresa e institucionit arsimor, pavarësisht se nuk janë në të njëjtin qark.

Neni 20

Deklarimi i vendbanimit pranë punëdhënësit apo institucionit arsimor

1. Shtetasit që për arsye pune/arsimimi ndryshojnë vendbanimin, janë të detyruar të paraqesin pranë institucionit shtetëror apo punëdhënësit, në çastin e fillimit të marrëdhënies së punës, ose pranë institucionit arsimor, në çastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik, një nga dokumentet që vërteton vendbanimin, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Në çdo rast, ky dokument duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i detyrës, marrëdhënies së punës ose paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik të studimeve. Në rast se regjistrimi në vitin akademik bëhet automatikisht dhe pa kërkesë, institucioni verifikon kushtet e parashikuara në këtë nen dhe, kur identifikon mangësi në dokumentacionin provues të vendbanimit, njofton brenda 5 ditëve shtetasin që ka detyrimin për deklarim, si dhe zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin arsimor.
2. Institucionet shtetërore dhe arsimore, si dhe punëdhënësit e përcaktuar në këtë nen, janë të detyruar të informojnë brenda 5 ditëve zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe që nuk kanë paraqitur ende dokumentin që vërteton vendbanimin.

3. Zyra e gjendjes civile, brenda 5 ditëve, në bashkëpunim me institucionin përkatës që ka bërë informimin, njofton me shkrim shtetasit, të cilët, për arsye pune apo arsimimi, janë vendosur me vendbanim në bashkinë/komunën në juridiksion të zyrës përkatëse të gjendjes civile, për detyrimin për regjistrim të vendbanimit dhe për sanksionet në rast mos-regjistrimi. Kur edhe pas kalimit të afatit për regjistrim, shtetasi nuk ka deklaruar vendbanimin e tij, zyra e gjendjes civile njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e komunikimit midis institucioneve apo punëdhënësve, subjekte të këtij neni, si dhe të njoftimit të shtetasve nga zyrat e gjendjes civile, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Neni 21

Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe i personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë në zyrën e gjendjes civile vendbanimin e tyre, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit nga organi kompetent.

Zyra që mbulon shtetësinë dhe refugjatët njofton brenda 5 ditëve DPGJC-në për çdo akt të ri për këtë kategori shtetasish.

2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim në Republikën e Shqipërisë, kur ndryshojnë vendbanim, janë të detyruar të njoftojnë zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të tyre brenda 30 ditëve nga ardhja në vendbanimin e ri.

Neni 22

Dokumentacioni për vërtetimin e vendbanimit dhe ndryshimit të tij

1. Zyra e Gjendjes Civile e regjistron deklarin e vendbanimit ose banesës për përdorim vetjak apo familjar të shtetasit kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

2. Këshilli i Ministrave përcakton dokumentacionin e nevojshëm që vërteton vendbanimin apo banesën për përdorim vetjak ose familjar të shtetasit, si dhe mënyrën e administrimit të këtij dokumentacioni nga zyra e gjendjes civile.

Neni 23

Çregjistrimi i personave që lënë shtetësinë shqiptare

Për shtetasit që, me dekret të Presidentit të Republikës, lënë shtetësinë shqiptare, DPGJC-ja u kërkon zyrave të gjendjes civile, ku shtetasit kanë vendbanimin e tyre, që brenda 30 ditëve të bëjnë çregjistrimin e tyre nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Neni 24

E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta

1. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.

2. Institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara që t'i sigurojnë akses të menjëhershëm e të papenguar DPGJC-së në bazat përkatëse të të dhënave, ose t'i dërgojnë asaj informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.

3. DPGJC-ja i përdor të dhënat e siguruar në zbatim të këtij neni, për aq sa është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Të dhënat e siguruar nga baza alternative të dhënash nuk përbëjnë burim të drejtpërdrejtë dhe të vetëm të dhënash,

në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. DPGJC-ja i përdor të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

4. Këshilli i Ministrave përcakton llojin, sasinë, organizimin e informacionit dhe rregullat për marrjen dhe përpunimin e informacionit, sipas këtij neni.

KREU IV NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 25

Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile.

Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretët, sipas ligjit.

2. Dokumentet bazë, që mban shërbimi i gjendjes civile, janë:

- a) akti i lindjes;
- b) akti i martesës;
- c) akti i vdekjes;
- ç) regjistrat themeltarë;
- d) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- dh) procesverbali/procesverbalet për ndryshim emri, mbiemri;
- e) procesverbali/procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar.

3. Dokumentet bazë, që lëshon zyra e gjendjes civile, janë:

- a) letërnjoftimi;
- b) pasaporta;
- c) certifikata e lindjes;
- ç) certifikata martesore;
- d) certifikata e familjare;
- dh) certifikata e vdekjes.

4. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Letërnjoftimi

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është letërnjoftimi.

2. Personat, të cilët, për efekt moshe, sipas ligjit, nuk përfitojnë letërnjoftim, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatën e lindjes me fotografi, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 27

Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

3. Aktet e lindjes, të martesës e të vdekjes, të mbajtura jashtë shtetit, në shërbimin diplomatik apo konsullor shqiptar, për shtetasit shqiptarë apo dhe për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcillen nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.

Neni 28

Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, si dhe shënojnë emrin e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, në çdo rast, shoqërohet me vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.

2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm në veprim.

Neni 29

Dokumentet e tjera bazë

1. Dokumente të tjera janë aktet zyrtare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat, sipas ligjit, vërtetojnë ose ndryshojnë faktet juridike, të vërtetuara me aktet e gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kur pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.

2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër, me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.

Neni 30

Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara

1. Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara bëhen vetëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kopja e vendimit gjyqësor i bashkëlidhet dokumentit dhe çdo dokument i lëshuar në bazë të tij përmban elementet e përcaktuara në vendimin gjyqësor.

2. Korrigjimet, si gabime materiale, përcaktohen me rregullore nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokument bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.

Neni 31

Detyrimet e organeve të tjera

Të gjitha organet, të cilat, në mbështetje të këtij ligji apo sipas një ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtpërdrejt, një kopje të aktit, vendimit, në zyrën e gjendjes civile, ku personi figuron i regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

Neni 32

Administrimi i dokumentacionit

1. Aktet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjegjësi i gjendjes civile në degën e qarkut/përgjegjësi i gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës rishikon saktësinë e veprimeve të kryera në aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve dhe, në bashkëpunim me nëpunësin përkatës të zyrës së gjendjes civile, bën mbylljen e tyre. Pas verifikimit, aktet dorëzohen në arkivin e degës së gjendjes civile të qarkut, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.

2. Dokumentet, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile, në njësinë e qeverisjes vendore, në muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

3. Me krijimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, regjistrat themeltarë të shtetasve në bashki/njësi bashkiake/komuna dorëzohen në arkivin e degës së gjendjes civile në qark, sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

4. Për administrimin e të gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V

REGJISTRI KOMBËTAR I GJENDJES CIVILE

Neni 33

Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile

1. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile është dokumenti unik shtetëror, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas shqiptar, për shtetasit e huaj dhe për personat pa shtetësi, kur kanë banim të përkohshëm/të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

2. Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Përditësimi i të dhënave të regjistrit bëhet nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.

3. Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike.

4. Mënyra e ngritjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe rregullat për shfrytëzimin e teknologjisë informatike që do të përdoren për këtë regjistr, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34

Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe nga nëpunësi në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 35

Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Përbërësit e gjendjes civile pasqyrohen në faqen individuale të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 36

Plotësimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Kur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që

nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

- a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
- b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;
- c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykatë.

Neni 37

Mungesa e së dhënës

1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.

2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

KREU VI

REGJISTRIMI I AKTIT TË LINDJES

Neni 38

Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 39

Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.

2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.

3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.

4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paafte mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.

5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paafte mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 40
Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

Neni 41
Regjistrimi i lindjes

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Fondi për shpërblimin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe tërhiqet pranë bashkisë/njësisë bashkiake/komunës përkatëse.

6. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 42
Akti i lindjes

1. Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.

2. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë dhe deklaruesi.

Ai përmban:

a) numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;

b) datën e plotë dhe orën e lindjes;

c) vendin e lindjes;

ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;

d) numrin e identitetit të fëmijës;

dh) gjininë;

e) kombësinë, në përputhje me kombësinë e prindërve;

ë) shtetësinë;

f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;

g) numrin e identitetit dhe identitetin e nënës;

gj) numrin e identitetit dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

h) identitetin, numrin e identitetit dhe cilësinë e deklaruesit;

i) numrin e identitetit, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Neni 43

Vlefshmëria dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.

2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.

3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrijnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.

4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 44

Ndryshimi i së dhënës së aktit të lindjes

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile mund të ndryshohet drejtpërdrejt nga nëpunësi i gjendjes civile në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, për emrin, mbiemrin dhe shtetësinë e përkohshme, ndërsa, me kërkesë të shtetasis përkatës, brenda 1 viti nga plotësimi i moshës madhore dhe pas kësaj me vendim gjykate.

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

1. Në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.

2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm apo kombësia, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklaramit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuara, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate.

4. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

KREU VII

REGJISTRIMI I AKTIT TË MARTESËS

Neni 46

Forma e aktit të martesës

1. Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

Neni 47

Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.

2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve.

3. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

4. Për të huajt, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

5. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesa mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të nxjerrë rregullat për veprimet, që do të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për dokumentacionin dhe procedurën që do të ndiqet.

Neni 48

Përmbajtja e aktit të martesës

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:

- a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës;
- b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës;
- c) numri dhe data e shpalljes së martesës;
- ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës;
- d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora;
- dh) identiteti, numri i identitetit të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm;
- e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës;
- ë) vendbanimi pas martesës;
- f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët;
- g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës;
- gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve;
- h) numri i identitetit, emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve;
- i) numri i identitetit, emri, mbiemri i përkthyesit;
- j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 49

Vërtetimi i martesës

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Neni 50

Veprimet me aktin e martesës

Akti i martesës pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëpunësi i gjendjes civile, që mban aktin e martesës, bën përditësimin e të dhënave për bashkëshortët e ardhshëm, në faqen përkatëse.

KREU VIII REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 51 **Akti i vdekjes**

1. Akti i vdekjes vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit.
2. Akti i vdekjes është procesverbali, që mbahet për çdo të vdekur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi.
Ai përmban:
 - a) zyrën e gjendjes civile, ku mbahet akti i vdekjes;
 - b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
 - c) vendin e vdekjes dhe orën;
 - ç) shkakun e vdekjes, sipas raportit mjekësor;
 - d) identitetin dhe numrin e identitetit të të vdekurit, ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura e pa identitet;
 - dh) numrin e identitetit, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit ligjor, që ka lëshuar raportin;
 - e) numrin e identitetit, emrin, mbiemrin e deklaruesit;
 - ë) numrin e datën e shkresës së prokurorisë, që ka autorizuar veprimin për rastet e përcaktuara në këtë ligj;
 - g) emrin, mbiemrin e nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 52 **Deklarimi i vdekjes**

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar madhor i familjes ose nga personat më të afërt të familjes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë/komunës, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi ka vendbanimin/vendqëndrimin ose ku është gjetur kufoma.
2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.
3. Deklarimi i vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.
4. Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre.
5. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarinin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.
6. Me deklarinin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.
7. Në fshatra, në juridiksionin e komunave, që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryeplaku i fshatit. Në këtë rast, kryeplaku, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.
8. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarinin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.
9. Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen, pasi të ketë shfrytëzuar të gjithë procedurën administrative.
10. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit

e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 53

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij.

Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil.

2. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

3. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.

4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes.

5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 54

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori.

Neni 55

Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.

2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

3. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkakat e vendit të vdekjes.

4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore apo fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij dhe, kur nuk ka të tillë apo kur kjo e drejtë nuk ushtrohet prej tyre, të drejtën e ka edhe prokurori.

5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit, që rezultojnë i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasojat juridike nga mungesa e aktit të vdekjes në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.

6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezultojnë i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.

7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.

8. Pavlefshmëria, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personat madhorë, që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur:

- a) kjo nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari;
- b) nuk ka të tillë;
- c) pasojat lidhen me shtetin.

9. Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes me vendim gjyqësor, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar ose në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile anulohen ose ndryshohen dhe ky veprim pasqyrohet në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

KREU IX

EMRI, MBIEMRI DHE NDRYSHIMI I TYRE

Neni 56

Emri e mbiemri

1. Nëpunësi i gjendjes civile pasqyron në aktin e lindjes emrin, që dëshirojnë prindërit e fëmijës, përveç emrave të papërshtatshëm.

2. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.

3. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër, me shënimin në kllapa “i përkohshëm”, deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.

4. Kur shkaku ka lindur pas regjistrimit të emrit, nuk ka papërshtatshmëri, sipas këtij ligji.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, kur konstaton një emër të papërshtatshëm, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e tij me vendim gjyqësor.

6. Mbiemri i fëmijës përcaktohet në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Familjes.

7. Kur prindërit kanë vdekur apo nuk janë në gjendje fizike a mendore ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe, në mungesë të tyre, nga nëpunësi i gjendjes civile.

Neni 57

Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit

1. Emri e mbiemri mund të ndryshojnë në rastet e përcaktuara në këtë ligj.

2. Emri e mbiemri i personit madhor mund të ndryshojnë vetëm me kërkesën e tij. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj mund të kërkojnë ndryshimin për rastet e papërshtatshmërisë.

3. Emri i personit mund të ndryshojë pas vdekjes, me kërkesë të personave, që kanë atë emër përbërës të gjendjes së tyre civile, vetëm për shkak të papërshtatshmërisë.

4. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcakton emrat e papërshtatshëm, në kuptim të këtij ligji, duke marrë mendim paraprak nga institucione të specializuara. Emrat e vlerësuar të papërshtatshëm me vendim gjyqësor përfshihen, drejtpërdrejt, në një përmbledhëse, që i vihet në dispozicion çdo zyre të gjendjes civile.

5. Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit të prindit pasqyrohet te fëmija i mitur. Te fëmija në moshën madhore ndryshimi mund të bëhet me pëlqimin e tij, përveç rasteve të papërshtatshmërisë.

6. Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pas miratimit të kërkesës së shtetasit, nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar. Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

7. Në bazë të procesverbalit ose të vendimit gjyqësor bëhen korrigjimet për personat, që kanë nënshkruar dhe për të miturit, ndërsa për pjesëtarët e tjerë madhorë, korrigjimet bëhen vetëm pasi të kenë dhënë pëlqimin me shkrim, të nënshkruar, të procesverbalit, përveç rasteve të vendosura nga gjykata.

8. Personat, që e kanë përbërës emrin ose mbiemrin, por që janë familje më vete, bëjnë ndryshimin me kërkesën e tyre, me procesverbal të veçantë, ndërsa në rastet e papërshtatshmërisë, janë të detyruar ta pasqyrojnë ndryshimin brenda 1 muaji nga marrja e tij.

9. Përveç ndryshimeve të mësipërme, emrit dhe mbiemrit mund t'i bëhen përmirësime dhe korrigjime, që lidhen me ndryshime e saktësime të shkronjave të veçanta. Këto ndryshime bëhen në bazë të kërkesës së personit të interesuar, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

KREU X KOMBËSIA DHE GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE E PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 58

Kombësia

1. Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë, të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur, sipas ligjit, vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve, ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndryshimin e atësisë apo të amësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor.

2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës madhor.

3. Fëmija e lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

4. Fëmija me prindër të panjohur, i lindur në Shqipëri, prezumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e pikës 2 të këtij neni.

5. I birësuar merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, por kur ai arrin në moshë madhore, ka të drejtë të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit, ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit biologjikë.

6. I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur, në çdo rast, si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material.

8. Ndryshimi i kombësisë shqiptare të shtetasve shqiptarë nga organe të huaja është absolutisht i pavlefshëm.

Neni 59

Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe shtetasit e huaj, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.

2. Gjendja civile e shtetasit të huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në dokumentet e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur. Gjendja civile e shtetasit të huaj, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë vërtetohet nga të dhënat, që ka organi përkatës administrativ për refugjatët.

3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm, vizitorë ose që janë tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose një procedurë të veçantë, të përcaktuar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

KREU XI SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 60 **Natyra dhe funksioni**

1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, përfitëson dhe administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi i gjendjes civile u jep të dhëna marrësve, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 61 **Organizimi i shërbimit të gjendjes civile**

1. Shërbimi i gjendjes civile është i organizuar si më poshtë:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - b) degët e gjendjes civile në qark;
 - c) zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake ose komuna.
2. Pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare funksionon shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 62 **Struktura dhe organika**

Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e gjendjes civile në qark përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63 **Buxheti**

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile duhet të përdoren në përputhje me aktet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë përdorimin dhe administrimin e të ardhurave që krijohen nga institucionet buxhetore.

2. Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Bashkitë, njësitë bashkiake dhe komunat, në përputhje me objektivin e tyre, mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë, për përmirësimin e shërbimit të zyrës së gjendjes civile.

Neni 64 **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 65 **Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile**

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:

- a) I propozon ministrit projektaktet në zbatim të ligjit.
- b) Harton dhe i propozon për miratim ministrit treguesit e cilësisë së shërbimit, metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.
- c) Administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave.
- ç) Harton programe dhe merr masa për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.
- d) Bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut, bashki, komuna dhe njësitë bashkiake, si dhe në përfaqësitë diplomatike e konsullore.
- dh) Bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projekt marrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim.
- e) Merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin dhe rekrutimin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.
- ë) Propozon modelet e dokumenteve që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që përdor ky shërbim.
- f) Vendosi kriteret profesionale që duhen plotësuar nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për pranimin e tyre në këtë shërbim.
- g) Kur vëren shkelje, i propozon kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake /komunës dhe prefektit të qarkut masa administrative për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Masat e propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe prefekti i qarkut.
- gj) Zgjidh konfliktet për veprimet apo mosveprimet e zyrave të gjendjes civile, në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 66

Degët e gjendjes civile në qark

1. Shërbimi i gjendjes civile i ushtron funksionet edhe në degët e qarkut.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të gjendjes civile në degët e qarkut bëhet nga prefekti, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kriterëve të përcaktuara më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të gjendjes civile të degës së qarkut bëhet nga prefekti, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 67

Detyrat e degëve të gjendjes civile në qark

Degët e gjendjes civile në qark kanë këto detyra:

- a) zbatojnë metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile, në shkallë rrethi;
- c) lëshojnë certifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollojnë veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna dhe u propozojnë organeve përkatëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raportojnë para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës së qarkut dhe të zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna.

Neni 68

**Zyrat e gjendjes civile në bashki,
njësi bashkiake ose komuna**

1. Shërbimi i gjendjes civile ushtron funksionet në bashki/njësi bashkiake/komuna.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 69

**Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki,
njësi bashkiake ose komuna**

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna kanë këto detyra:

- a) përditësojnë Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- b) mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
- c) lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi;
- d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara;
- dh) vënë në dijeni këshillin dhe kryetarin e bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, si dhe degën e gjendjes civile në qark, për veprimtarinë e zyrës së gjendjes civile, sipas kërkesës ose periodikisht, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- e) plotësojnë të gjitha detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 70

Detyrat e zyrës së gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës

Zyra e gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës ka këto detyra:

- a) zbaton metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësive bashkiake të Tiranës;
- c) lëshon certifikata të shërbimit të gjendjes civile për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrave të gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u jep të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranon dhe shpërndan, në zyrat e gjendjes civile të njësive bashkiake të Tiranës, njoftimet që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollon veprimtarinë, që kryejnë zyrat e gjendjes civile në njësitë bashkiake dhe u propozon organeve përgjegjëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raporton para kryetarit të bashkisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e zyrës në bashki dhe të zyrave të gjendjes civile në njësitë bashkiake.

Neni 71

**Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike
dhe konsullore**

Veprimet, të cilat kryhen nga nëpunësit e shërbimit konsullor, që mbulojnë çështjet e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare, duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara nga ligji në fuqi. Këta nëpunës, përpara fillimit të punës, duhet të trajnohen si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Ata administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, që janë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

Neni 72

Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, ndërsa për përfaqësitë diplomatike e konsullore, vetëm nëpunësit e trajnuar për këtë qëllim.

Neni 73

Tarifat e shërbimit të gjendjes civile

Shërbimet, që kryhen nga zyrat e gjendjes civile, kryhen me pagesë nga kërkuesi, marrësi ose deklaruesi, sipas tarifave të miratuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose moszbatimi i dispozitave të parashikuara në nenin 15 pika 3, në nenin 19 pikat 1 e 2, në nenin 20 pika 1, në nenin 21 pikat 1 e 2, në nenin 41 pika 6 dhe në nenin 52 pikat 3, 5 dhe 7 dënohet me gjobë në masën 3 000 lekë dhe me pezullim të shërbimit deri në vjeljen e gjobës, të cilën e vendos dhe e vjel nëpunësi i gjendjes civile.

Gjoka e vendosur nga nëpunësi i gjendjes civile mund të ankimohet brenda 10 ditëve te prefekti i qarkut, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës;

b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në nenin 18 pikat 2 e 3, në nenin 20 pikat 1 e 2, në nenin 41 pika 6 dhe në nenin 52 pika 4 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

c) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në nenin 65 shkronja “dh”, në nenin 66 pikat 2 dhe 3 dhe në nenin 68 pika 2 dhe 3 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

2. Gjokat e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të këtij neni vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, sipas njoftimit të ardhur nga zyrat e gjendjes civile. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në institucionin e ministrit që mbulon gjendjen civile, i cili brenda 10 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

3. Masat administrative të gjobës, të cilat nuk ankimohen brenda afatit, si dhe ato të cilat lihen në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat përmbarimore për ekzekutimin e tyre.

KREU XII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 15 pika 4, 18 pikat 3 dhe 4, 20 pika 4, 22 pika 2, 24 pika 4, 25, 33, 52 pika 10, 62 dhe 63 të këtij ligji.

Neni 77

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6180, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 12.6.2009
Doli nga shtypi më 12.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë